



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1251/ 12 prot.

Datë 24.07.2025

V E N D I M
Nr. 955/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.07.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, “Filara” SHPK dhe “Albdesign PSP” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - mallra mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34415-12-23-2024, me objekt: “Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”, me fond limit 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (dyqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 23.12.2024, 1 euro = 98.65 All, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK, me NIPT K11501002D, me adresë Rruga “Lord Bajroni”, Laprakë, Tiranë.

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, me NIPT L52122014L, me adresë Rruga “Siri Kodra”, Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
Adresa: Blv “Gj. Fishta”, Nd. Nr. 88, H.1, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.12.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur - mallra mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34415-12-

23-2024, me objekt: “*Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a*”, me fond limit 22,448,930 (*njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë*) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (*dyqind e njëzet e shtate mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre*) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 23.12.2024, 1 euro = 98.65 All, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

II.2. Në datën 25.03.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 25.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Adel Co” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
2. “Filara” SHPK	12,730,260	lekë kualifikuar
3. “Inpress” SHPK	16,133,000	lekë kualifikuar
4. “Kristalina KH”	16,387,700	lekë kualifikuar
5. “Marketing & Distribution” SHPK	16,517,100	lekë kualifikuar
6. “Dynamicx Group” SHPK	17,841,300	lekë kualifikuar
7. “Infosoft Office” SHPK	18,599,665	lekë kualifikuar
8. “Albdesign PSP” SHPK	19,522,800	lekë kualifikuar
9. “Olsoni” SHPK	20,731,500	lekë kualifikuar

II.4. Në datën 25.04.2025, operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 08.05.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “*Publikimi i Njoftimit të Fitusit Paraparak*” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në datën 14.05.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5308 dhe me numër 1251/2025 prot., datë 14.05.2025 e operatorit ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur - mallra mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-34415-12-23-2024, me objekt: “*Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a*”, me fond limit 22,448,930 (*njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë*) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (*dyqind e njëzet e shtate mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre*) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 23.12.2024, 1 euro = 98.65 All, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të

Vlerësimi të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK, “Filara” SHPK dhe “Albdesign PSP” SHPK, me argumentat si më poshtë vijonë:

Të nderuar anëtare të KSHA dhe KPP-se, AK me datë 25.04.2025 në faqen e APP-se ka publikuar vlerësimet, më poshtë po ju paraqesim pretendimet tona në lidhje me vlerësimet e Filara dhe Inpress pjesëmarrës në këtë procedurë të cilët nuk përmbushin kriteret e kualifikimit. Po ashtu ne datën 08.05.2025 është publikuar njoftimi i fituesit dhe brenda parashikimeve ligjore po paraqesim aneksen tone.

Së pari OE Filara nuk plotëson pikën 2.3.1 në kriteret e vecanta të kualifikimit e cila kërkon si më poshtë: 2.3.1 për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Sipas pikës së mësipërme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e furnizimeve të mëparshme duhet të përfaqësojë të paktën 35% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës., Vlera e fondit limit është 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) (Monedha) leke pa TVSH, që do të thotë se operatori duhet të paraqesë dokumentacion për furnizime të realizuara me vlerë minimale prej 7857125.5, një vlerë e cila jemi të bindur që operatori ekonomik Filara nuk e plotëson.

Së dyti në Shtojcë Nr.1 Per Modifikimin e Dokumentave te Tenderit 2 në pikën 2.3.5 të modifikuar të Kapaciteteve Teknike në dokumenta tenderit kërkohet: 2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës ne rast se do të jete vete prodhues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Makinë shtypi 50 x 70 4 C ose me përmasa më të mëdha*
- Makineri te posacme per kryerjen e procesit te llakimit*
- Makinë qepse me pe me permasa 35 x 25*
- Makinë prerje me permasa 80 x 110*
- Makine qepese me tel*

- Thikë një anëshe

Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.

Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësine e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji).

Ne rast se operatori ekonomik do ti siguroje mallrat objekt i ketij prokurim nga prodhues te tjere duhet te paraqese autorizim prodhuesi i cili duhet të permbajë të dhena të plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ne rast se do te jete vete prodhues.

Sqarim: Përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 ipër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikë i ndryshuar.

- *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).*

Pas kërkeses per sqarim drejtuar autoritetit kontraktor ne SPE eshte ngarkuar pergjigje dhe konkretisht: Pershendetje, ne vijim te kërkeses tuaj per sqarim autoriteti kontraktor ben me dije te gjithe operatoret ekonomik te interesuar qe permasat e makineris te posacme per kryerjene procesit te llakimit duhet te jene te njejta me permasat e makinerise se shtypi pra 50 x 70 ose me permasa me te medha. Faleminderit. Kjo makineri eshte dhe objekt verifikimi bazuar ne vendimin e ndermjetem te KPP 441/2025 ku bazuar ne kete vendim fatura per kete makineri eshte objekt inspektimi pasi ka dyshime per deklarim te rreme/fallso. Përvec kesaj kjo fature nuk ka permasa dhe habitemi se si KSHA e ka kaluar kete pa e vene re. Po ashtu jemi te bindur qe OE Filara nuk ka makineri prerje me format 80 x 100 dhe makineri qepje me pe 35 x 25, ndaj kerkojme qe te shikohen ne detaje pershkrimet e faturave dhe kontratat e qerese nese e kane pershkrimin sipas kërkesave te DST.

Së treti nga verifikimi në ekstraktin e regjistrimit tregtar të QKB, rezulton se objekti i aktivitetit i subjektit “Filara” SHPK është i lidhur me:

- *Botime librash, materiale letrare, shkollore e universitare,*
- *Agjenci trajnimesh profesionale,*
- *Tregtim materialesh didaktike, zyrash, lodrash, etj.*

Në asnjë rast nuk përfshihen produkte apo shërbime të lidhura me materiale arkive apo pajisje të specializuara për arkivim, të cilat janë pjesë përbërëse e objektit të kësaj procedure. Bazuar në këtë fakt, vlerësojmë se subjekti në fjalë nuk përmbush kriteret ligjore të përshtatshmërisë sipas objektit të veprimtarisë, duke cënuar kështu parimet e konkurrencës së ndershme dhe barazisë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Per sa i perket OE Inpress së pari nuk plotëson pikën 2.3.1 në kriteret e vecanta të kualifikimit e cila kërkon si më poshtë: 2.3.1 për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Sipas pikës së mësipërme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e furnizimeve të mëparshme duhet të përfaqësojë të paktën 35% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës., Vlera e fondit limit është 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) (Monedha) leke pa TVSH, që do të thotë se operatori duhet të paraqesë dokumentacion për furnizime të realizuara me vlerë minimale prej 7,857,125.5, një vlerë e cila jemi të bindur që operatori ekonomik Inpress nuk e plotëson.

Së dyti në Shtojcë Nr.1 Per Modifikimin e Dokumentave te Tenderit 2 në pikën 2.3.5 të modifikuar të Kapaciteteve Teknike në dokumenta tenderit kërkohet: 2.3.5.Operatori ekonomik pjesëmarrës ne rast se do te jete vete prodhues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Makinë shtypi 50 x 70 4 C ose me përmasa më të mëdha*
- Makineri te posacme per kryerjen e procesit te llakimit*
- Makinë qepse me pe me permasa 35 x 25*
- Makinë prerje me permasa 80 x 110*
- Makine qepese me tel*
- Thikë një anëshe*

Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.

Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji). Ne rast se operatori ekonomik do ti siguroje mallrat objekt i ketij prokurim nga prodhues te tjere duhet te paraqese autorizim prodhuesi i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ne rast se do te jete vete prodhues.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 ipër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikë i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

Kemi bindjen se operatori ekonomikë Inpress nuk disponon makinë prerje me permasa 80 x 110 dhe makineri qepse me penj sipas formatit te percaktuar ne DST. Ne baze te dokumentave te marre nga nje procedure gjyqesore me subjekt ata, kemi dokumentacionin qe ata disponojne qepese me penj pa asnje format, si cdo dokumentacion te paplote qe disponon OE Inpress. Kjo krijon një hendek të rëndësishëm në kapacitetin e tyre për të përmbushur detyrimet e kontratës si edhe një deklaram të rremë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për disponimin e këtyre makinerive. Ndaj kërkojmë nga AK dhe KPP verifikimin e faturave/kontratave të qirasë e kesaj makinerie të deklaruar nga ky OE që të korrespondojnë me pershkrimin dhe formatin e kërkuar.

Se fundmi sipas dokumentacionit të bërë publik, oferta e paraqitur nga OE “Albdesign PSP” sh.p.k ka një vlerë prej 23,427,360 lekë me TVSH, ndërkohë që fondi limit i përcaktuar për këtë procedurë është 22,448,930 lekë. Pranimi i kësaj oferte cënon parimet e barazisë, konkurrencës së ndershme dhe barazisë së trajtimit të operatorëve ekonomikë, ndaj me skualifikimin e kesaj oferte, oferta e OE Filara do te dilte tashme oferte anomalisht e ulet.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1251/1 datë

14.05.2025, me kriteret kualifikuese për të cilat pretendohet nga ana e ankimuesit se nuk përmbushen nga ana e operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK, “Filara” SHPK dhe “Albdesign PSP” SHPK.

II.8. Në datë 19.05.2025 bashkëlidhur shkresës me lëndë “Dorëzohen argumentat e palës së interesuar”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1251/2 prot., datë 19.05.2025 operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike.

II.9. Me shkresën nr. 46 prot, datë 20.05.2025, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1251/3 prot., datë 21.05.2025 operatori ekonomik “Filara” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur, nëpërmjetë shërbimit postar.

II.10. Me shkresën me nr. 4712/2 prot., datë 26.05.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1251/4 prot., datë 26.05.2025 autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.11. Në datën 03.06.2025 Komisioni i Prokurimit Publik mori Vendimin Nr. 738/2025, në të cilin u vendos si vijon:

1. Të urdhërojnë paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar të tyre, nga ana e operatorit ekonomik “Inpress” Shpk, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-34415-12-23-2024 me objekt: “Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”, me fond limit 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (dyqind e njëzet e shtate mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 25.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
2. Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 12.06.2025.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.12. Në datën 11.05.2025 nëpërmjet shkresës me objekt “Dorëzohet dokumentacioni kualifikues, në mbështetje të vetëdeklarimeve të paraqitura nga operatori ekonomik Inpress shpk” protokolluar me tonën me nr. 1251/9 prot, datë 11.06.2025 është depozituar nga ana e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK dokumentacioni i kërkuar nëpërmjetë vendimit nr. 738/2025., datë 03.06.2025, në total 728 faqe.

II.13. Referuar informacionit të Autoritetit Kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 25.04.2025, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së

prokurimit duke njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, përkatësisht:

1. “Adel Co” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
2. “Filara” SHPK	12,730,260	lekë kualifikuar
3. “Inpress” SHPK	16,133,000	lekë kualifikuar
4. “Kristalina KH”	16,387,700	lekë kualifikuar
5. “Marketing & Distribution” SHPK	16,517,100	lekë kualifikuar
6. “Dynamicx Group” SHPK	17,841,300	lekë kualifikuar
7. “Infosoft Office” SHPK	18,599,665	lekë kualifikuar
8. “Albdesign PSP” SHPK	19,522,800	lekë kualifikuar
9. “Olsoni” SHPK	20,731,500	lekë kualifikuar

II.14. Në datën 25.04.2025, operatori ekonomik “Inpress” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kkalifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.15. Në datën 08.05.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fitusit Paraparak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.16. Në datën 14.05.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/5313 dhe me numër 1256/2025 prot., datë 14.05.2025 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - mallra mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34415-12-23-2024, me objekt: “Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”, me fond limit 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (dyqind e njëzet e shtate mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 23.12.2024, 1 euro = 98.65 All, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjiise Elektrike Group sh.a. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit “Filara” SHPK me argumentat si më poshtë vijonë:

Përsa i përket vendimit të KVO të AK, për kualifikimin e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, ju paraqesim kundërshtitë tona si vijon: Argumentime mbi shkeljet e pretenduara përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Të nderuar zotërinj, KVO e AK ka kualifikuar në mënyrë të gabuar OE Filara shpk., në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të fushës aktualisht në fuqi, si dhe në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST e procedurës prokuruese objekt ankese, për arsytet e mëposhtme:

Së pari, në kundërshtim me gjurmën “e”, të pikës 3, të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe të shtojcës 8, Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit të DST, ...Operatori ekonomik Filara shpk. Ndodhet në kushtet e skualifikimit të detyrueshëm, pasi “...Operatori ekonomik Filara shpk. Ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncensionare që ka cuar në përfundimin e kësaj kontrate”. Në gjurmën “e”, të pikës 3, të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, përcaktohet: “3. cdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: e) Operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncensionare që ka cuar në përfundimin e kësaj kontrate”. Në :Formularin e Njoftim Fituesit”, të publikuar në faqen zyrtare të APP-së, në datë 20.08.2024, nga AK Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës, referuar një tjetër procedure prokuruese REF-11465-06-28-2024, “Blerje diploma - marrëveshje kuadër për 24 muaj”, përcaktohet: “...3. Operatori Ekonomik “Filara” shpk, me NUIS K51611059N, me ofertë ekonomike 2.185.600 (dy milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH dhe 2.622.720 (dy milion e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet) lekë me TVSH ndodhet në kushtet e skualifikimit për arsye se është në kushtet detyruese për skualifikim parashikuar në gjurmën e të pikës 3 te nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “3. cdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncensionare që ka cuar në përfundimin e kësaj kontrate. Ky kusht i referohet marrëdhënies kontraktuale të mëparshme, jo të suksesshme që ka patur me Autoritetin Kontraktor Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, duke mospërmbushur kontratën e nënshkruar me Nr. 256/30, datë 04.12.2023 me objekt: “Loti 5 Blerje libra per bibliotekën e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës”, si dhe amendimit të kontratës me Nr.216/2 Prot., datë 31.01.2024 me Kontraktuesin “Filara” shpk, të cilën është dërguar “njoftim për ndërprerje kontrate për mospërmbushje, me Nr.216/8 Prot., datë 27.02.2024, si dhe Raportimi mbi mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale, drejtuar Agjensisë së Prokurimit Publik, me Nr.216/10 Prot., datë 08.03.2024. Nisur nga ky fakt, bazuar në shkresën me Nr.1315 Prot., datë 18.07.2024, me lëndë: “Kërkesë për sqarim”, drejtuar Agjensisë së Prokurimit Publik, si dhe në shkresën me Nr.5227/1 Prot., datë 26.07.2024, Kthim përgjigje nga Agjencia e Prokurimit Publik, protokolluar në Institucion me Nr.1315/1Prot., datë 01.08.2024, komisioni i vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave rivleresoi procedurën e prokurimit duke skualifikuar operatorin ekonomik “Filara” shpk, në zbatim të parashikimit ligjor te sipërcituar.

Nisur nga sa mësipër, gjykojmë se AK OSHEE Group sh.a. do të duhet të skualifikojë OE Filara shpk., pasi ky operator ekonomik ndodhet në kushtet e skualifikimit të detyrueshëm, bazuar në gjurmën “e”, të pikës 3, të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Pra, nuk është e mundur, që një Autoritet Kontraktor (Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës), pas korrespondencës me Agjencinë e Prokurimit Publik, e skualifkon OE Filara shpk., ndërsa

një Autoritet tjetër Kontraktor (OSHEE Group sh.a.) e kualifikon OE Filara shpk. Rrjedhimisht, do të kërkonim nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara se të marrin një vendim të arsyetuar në lidhje me këtë pikë të kësaj ankese, të marrin një informacion zyrtar me shkrim nga Agjencia e Prokurimit Publik, mbi statusin e OE Filara shpk., si dhe nëse një procedurë audituese / hetuese ka nisur apo jo ndaj këtij operatori ekonomik. Bashkëlidhur, gjeni “Formularin e Njoftim Fituesin”, të publikuar në faqen zyrtare të APP-së, në datë 20.08.2024, nga AK Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës.

Së dyti, operatori ekonomik “Filara” shpk., ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët. Fondi limit i përcaktuar në DST për këtë procedurë prokurimi është 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH. Oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” është në vlerën e 12,730,260 (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH. Thënë ndryshe kjo ofertë është 45% (dyzet e pesë përqind) më e ulët se vlera e fondit limit, si dhe sa 71% e mesateres se ofertave të vlefshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokuruese. Do të mjaftonin këto vlera / shifra, që oferta ekonomike e paraqitur nga OE Filara shpk të konsiderohej anomalisht e ulët nga KVO e AK, dhe rrjedhimisht ky operator ekonomik të skualifikohej nga kjo procedurë prokuruese. Në zbatim të nenit 93, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 82, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke iu referuar procedurës prokuruese të lartpërmendur, kjo ofertë do të duhej të konsiderohej i) anomalisht e ulët, dhe si rrjedhojë të konsiderohej ii) e papranueshme nga KVO e AK.

Më poshtë ju parashtrojmë në mënyrë të detajuar se ky operator ekonomik, bazuar në cmimet për njesi të ofertuara, dhe vlerës totale të ofertuar nuk arrin të realizojë pjesën dërrmuese të artikujve/mallrave të kërkuara nga DST për këtë procedurë të prokurimit publik. Në nenin 93, pika 1 dhe 2, të LPP që përcakton se: 1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për cmimin ose kostot e propozuara në ofertë. 2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen vecanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

d) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

e) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Në përputhje me nenin 93, pika 1, të LPP, OE Filara shpk do të duhet të japë në mënyrë të detajuar shpjegimet në lidhje me:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) Zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) Originalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
d) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

e) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore:

Vetëm pasi, OE të ketë dhënë në mënyrë të detajuar shpjegimet për secilën prej shtyllave të lartpërmendura, duke sqaruar në mënyrë shteruese arsyet teknike dhe mundësinë e realizueshmërinë së kontratës (duke mos rrezikuar kështu realizimin e kontratës), bazuar në vlerën e ofertuar prej tij, atëherë AK do të mund të vlerësonte nëse kjo ofertë ekonomike mund të konsiderohej ose jo e pranueshme, duke mos rrezikuar kështu për asnjë moment realizimin e kontratës. Referuar nenit 93, pika 1, të LPP, bazuar në sasinë dhe specifikimet teknike të mallrave, nisur edhe nga eksperiencia dhe ekspertiza e padiskutueshme e stafit teknik të specializuar të OE Inpress shpk., e cila është ndër shoqëritë tregtare më të mëdha, që operon në tregun shqiptar për prodhimin e materialeve të arkivës, do të donim t'ju theksonim se OE "Filara" shpk e ka të pamundur teknikisht të prodhojë mallrat e kërkuara (sipas specifikimeve, cilësisë dhe sasive të përcaktuara në DST) në vlerën e ofertuar prej tij, dhe rrjedhimisht e ka të pamundur të realizojë me sukses kontratën e prokuruar, për arsyet e mëposhtme:

i) Fillimisht do të donim t'ju informonim se procesi i prodhimit të produkteve / artikujve të arkivës është kompleks, ku ekzistojnë një sërë faktorësh, të cilët diktojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë koston e prodhimit, dhe si rrjedhojë cmimet e ofruara. Zërat kryesorë të kostove që ndikojnë drejtëpërdrejtë në procesin e prodhimit janë: i) Kosto e lëndëve dhe materialeve të para (letër + karton, lastra, format, tonerat, bojrat, etj.); ii) Kosto e punës (orët punës) e stafit teknik dhe administrativ; iii) Shpenzimet e përgjithshme administrative, etj.

ii) Bazuar në elementët teknikë të lartpërmendur, bazuar gjithashtu në sasinë dhe specifikimet teknike të mallrave të kërkuara në DST, nga përlllogaritja e bërë nga stafi teknik i specializuar i OE Inpress shpk., vetëm KOSTO e prodhimit të këtyre mallrave është më e lartë se vetë oferta ekonomike e paraqitur nga OE "Filara" shpk., e cila është në vlerën e 12,730,260 lekë pa TVSH. Nuk kuptohet se si ky OE do të mund të realizojë këtë kontratë prokuruese, dhe pa e rrezikuar atë, ku vetëm Kosto e Prodhimit është më e lartë se Oferta Ekonomike e paraqitur...???

iii) Sic mund të vërehet lehtësisht, produktet / mallrat e kërkuara nga DST, nuk mund të prodhohen / realizohen nga OE "Filara" shpk., duke marrë për bazë vetëm koston e prodhimit të tyre. Këtu do të donim të theksonim gjithashtu, që në këtë analizë, nuk është marrë parasysh asnjë marzh fitimi (pra marzhi i fitimit është konsideruar "0"). Fakt ky, i cili e bën teorikisht dhe ekonomikisht të pamundur realizimin e këtyre produkteve.

iv) Bazuar në faktet e lartpërmendura, OE "Filara" shpk do të duhej, në përputhje me nenin 93, pika 1, të LPP-së, të provojë / vërtetojë qartësisht përpara AK, se çfarë vecorish dhe teknologjish inovative / alternative ka / përdor shtypshkronja "Filara" shpk., të cilat e mundësojnë atë, që bazuar në vlerën e ofertuar, jo vetëm përballon të gjitha Kostot e prodhimit të mallrave, por edhe të ketë një marzh minimal fitimi, duke mos rrezikuar kështu për asnjë moment realizimin e kontratës.

Bazuar në njohuritë, informacionet dhe eksperiencat tona të tregut të prodhimit të artikujve të arkivës në Republikën e Shqipërisë, OE Filara, nuk ka asnjë vecori apo aftësi teknologjike inovative / alternative në raport me OE e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë prokuruese, përkundrazi, ky operator ekonomik është shumë më i vogël se të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokuruese, pa kurrëfarë eksperience / punë të ngjashme në prodhimin e materialeve / produkteve të arkivës, si dhe nuk duhet harruar fakti, që një ndër ato shumë të pakta procedura prokuruese ku OE Filara shpk. Është shpallur fitues (referuar një tjetër procedure prokuruese, me AK Universiteti aleksandër Moisiu durrës, REF-11465-06-28-2024, “Blerje diploma - marrëveshje kuadër për 24 muaj”), ky operator ekonomik nuk ka arritur të realizojë me sukses kontratën prokuruese.

Rrjedhimisht, OE Filara shpk., NUK jep asnjë garanci teorike, praktiko / teknike dhe ligjore, që do të mund të realizojë me sukses furnizimin me mallrat e kërkuara në procedurën prokuruese, objekt ankese, pasi përvec se oferta ekonomike e paraqitur prej tij është tërësisht dhe anomalisht e ulët (më e ulët se Kostot e Prodhimit), ky operator ekonomik ka edhe precedentë të këtij viti 2024, që nuk ka mundur të realizojë me sukses një kontratë prokuruese me AK Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës.

Së fundi, do të donim të shtonim se OE Filara shpk është përsëritës (recidiv) në paraqitjen e ofertave ekonomike të pamenduara dhe tërësisht anomalisht të ulta, si dhe pa kurrëfarë përllogaritje teknike paraprake të kostove të prodhimit, në procedura të ndryshme të prokurimit publik. Mjafton t'i referohemi këtu një vendimi rishtas së Komisionit të Prokurimit Publik, Vendim KPP Nr. 1521/2024, datë 29.10.2024 (bashkëlidhur kësaj ankese), ku OE Filara shpk. është skualifikuar nga procedura prokuruese pikërisht me arsyetimin e paraqitjes së një oferte ekonomike anomalisht të ulët, tërësisht të paargumentuar dhe të pajustificuar,... ..për kuptuar që ky operator ekonomik është përsëritës në paraqitjen e ofertave ekonomike të papranueshme, të cilat kanë potencial real të vendosin në rrezik realizimin me sukses të kontratës prokuruese, duke rrezikuar gjithashtu shkaktimin e një dëmi të madh kundrejt autoritetit kontraktor.

Në rastin konkret, oferta anomalisht e ulët e OE Filara shpk shoqërohet edhe me mungesën totale të eksperiencës / punëve të ngjashme në prodhimin e materialeve të arkivës (si kuti, dosje, etj., të cilat zenë mbi 95% të volumit të artikujve të kërkuar) “intro”, e cila reflektohet gjithashtu edhe në mungesën totale të përfshirjes së objektit të procedurës prokuruese në objektin e veprimtarisë së OE Filara shpk. (në ekstraktin historik / objekti i veprimtarisë tregtare të OE Filara shpk mungon plotësisht objekti i procedurës prokuruese, si dhe zërat kryesorë të saj si: prodhim / tregtim kuti, dosje, etj., të cilat zenë më shumë se 95% të volumit të mallrave të kërkuar në dst) “intro”. Përsa mësipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të lartpërmendura... ..KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik “KPP”, do të duhet të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së treti, operatori ekonomik Filara shpk. NUK ka në objektin e veprimtarisë së tij tregtare, objekt e prokurimit publik iblerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a, si dhe NUK ka në objektin e veprimtarisë së tij tregtare “prodhimin apo tregtimin” e asnjë prej mallrave / produkteve / artikujve si: “kuti kartoni, dosje kartoni të llojeve të ndryshme, etj”., të cilat zenë mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve / artikujve të kërkuar në DST. Objekti

i plotë i veprimtarisë tregtare i OE Filara shpk është si mëposhtë: “Shtepi Botuese, botime të ndryshme, artistike, letrare, shkollore, universitare dhe botimeve të monografive shkencore në fushën e albanologjisë. Shtypshkronje, shtypshkrime me element sigurie, fletëpalosje, agjenda, flyer, katalog, kartvizita, banera, postera, roll up, kalendar muri, kalendar tavoline, canta, revista, letra me koke, blloqe recetash, stilolapsa me logo, broshura, zarfa, etiketa, etj. Agjenci trajnimesh për zhvillimin e vazhduar profesional, trajnimin dhe certifikimin e punonjesve arsimor, trajnime të ndryshme. Tregtim kancelarish të ndryshëm, mjete didaktike mesimore, produkte të ndryshme për arte dhe zeje. Organizim eventesh, dekore, festa dhe materiale promocionale të ndryshme. Printime dixhitale të të gjithave llojeve të reklamave dhe tabelave, logime, brandime, video promocionale, gjenerim platforme dixhitale, zhvillim dhe menaxhim aplikacioni ëëbi, etj”. - përfundon këtë / ekstrakt historik i shoqërisë tregtare Filara shpk / datë 14.05.2025. Sic mund të vihet re lehtësisht, në objektin e veprimtarisë tregtare të OE Filara shpk mungon plotësisht objekti i prokurimit publik “Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”, si dhe mungon plotësisht veprimtaria tregtare e “prodhimit apo tregtimit të mallrave / produkteve / artikujve si: kuti kartoni, dosje kartoni të llojeve të ndryshme, etj., të cilat zenë mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve / artikujve të kërkuar në DST”. Kjo mungesë është mëse normale përse i përket OE Filara shpk., pasi ky operator ekonomik nuk është as prodhues dhe as tregtues i “materialeve të arkivës”, dhe mallrave / produkteve / artikujve kuti kartoni dhe dosje kartoni, etj. Në kemi bindjen (duke njohur mirë tregun e prodhimit dhe tregtimit të materialeve të arkivës (si: kuti kartoni dhe dosje kartoni, etj.), që OE Filara shpk. NUK ka në objektin e veprimtarisë së tij tregtare mallrat / materialet objekt prokurimi, pasi nuk i ka prodhuar apo tregtuar asnjëherë më parë (nuk ka eksperiencë / punë të ngjashme “intro”). Përse mësipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të fushës së prokurimit publik, gjykojmë se është e papranueshme (për të mos thënë skandaloze), që KVO e AK ka kualifikuar OE Filara shpk., për aq kohë sa në veprimtarinë tregtare të OE Filara shpk. Nuk ekziston objekti i prokurimit publik, si dhe “prodhimi apo tregtimi” i mallrave / produkteve / artikujve si: kuti kartoni, dosje kartoni të llojeve të ndryshme, etj., të cilat zenë mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve / artikujve të kërkuar në DST. Rrjedhimisht, KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik “KPP”, do të duhet të ndryshojnë vendimin e KVO së AK, dhe të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së katërti, operatori ekonomik Filara shpk. NUK ka asnjë eksperiencë / punë të ngjashme për prodhimin dhe / ose tregtimin e materialeve të arkivës si: kuti kartoni, dosje kartoni, etj., të cilat zenë mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve të kërkuara në objektin dhe DST e prokurimit publik, objekt ankese. Në pikën 2.3.1. “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, përcaktohet: 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Vlera e fondit limit i procedurës prokuruese objekt ankese është: 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) leke pa TVSH. 35% e vlerës së fondit limit është: 7,857,125.5 (shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e pesë presje pesë) lekë pa TVSH. Vlera e faturave për eksperiencat / punët e ngjashme që do të duhet të paraqesin operatorët ekonomikë pjesëmarrës për mallrat / produktet / materialet e arkivës si: kuti kartoni, dosje kartoni, etj., (të cilat zenë realisht mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve / materialeve të kërkuara në DST, por për qëllime thjeshtëzimi po marrim si të mirëqenë se zenë vetëm 90% të volumit të mallrave të kërkuara), është minimalisht: 7,071,413 (shtatë milion e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH. Duke njohur shumë mirë tregun shqiptar të prodhimit dhe tregtimit të mallrave / produkteve / materialeve të arkivës, si kuti kartoni, dosje kartoni, etj., ne kemi bindjen se OE Filara shpk. Nuk ka paraqitur pranë AK OSHEE Group sh.a faturat me anë të së cilës të vërtetojë / provojë eksperiencën / punën e ngjashme për prodhimin dhe/ose tregtimin e mallrave / produkteve / materialeve të arkivës, si kuti kartoni, dosje kartoni, etj., në vlerën minimalisht të: 7,071,413 (shtatë milion e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH. Dihet botërisht, që OE Filara shpk nuk është as prodhues dhe as tregtues i mallrave / produkteve / materialeve të arkivës, si kuti kartoni, dosje kartoni, etj. Rrjedhimisht, nuk është e mundur që OE Filara shpk të ketë lëshuar fatura tatimore për shitjen e produkteve të lartërmendura, kur ky operator ekonomik nuk është as prodhues dhe as tregtues. Përveç OE Filara shpk., të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokuruese, janë ose prodhues dhe/ose tregtues të mallrave / produkteve / materialeve të arkivës, si kuti kartoni, dosje kartoni, etj. Përsa mësipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të fushës së prokurimit publik, gjykojmë se është e papranueshme (për të mos thënë skandaloze), që KVO e AK ka kualifikuar OE Filara shpk., për aq kohë sa OE Filara shpk nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm teknik (fatura tatimore / vërtetim / kontrata), me anë të së cilës të vërtetojë / provojë eksperiencën e ngjashme për “prodhimin dhe/ose tregtimin e mallrave / produkteve / artikujve si: kuti kartoni, dosje kartoni të llojeve të ndryshme, etj., të cilat zenë mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve / artikujve të kërkuar në DST”. Rrjedhimisht, KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik “KPP”, do të duhet të ndryshojnë vendimin e KVO së AK, dhe të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Së pesti, operatori ekonomik Filara shpk nuk disponon personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi. Në pikën 2.3.4. “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, përcaktohet: “Operatori Ekonomik duhet të ketë në

stafin e tij nje specialist me titullin “Dizajner”. Kjo të vërtetohet me dokumentacion (diplome ne rast se specialisti ka mbaruar shkolle te larte ose certificate/deshmi te leshuar nga organet e akredituara sikurse parashikon ligji nr. 15 i vitit 2017 “Per Arsimin dhe Formimin Profesional ne Republiken e Shqiperise qe provon titullin “Dizajner”) dhe kontratën e punës. Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin). Ne kemi bindjen që OE Filara shpk nuk disponon të personelin teknik të nevojshëm “nje specialist me titullin dizajner”, referuar objektit të prokurimit, të kërkuar në DST. Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Filara shpk nuk ka paraqitur pranë AK dokumentacionin e nevojshëm ligjor:

- diplome ne rast se specialisti ka mbaruar shkolle te larte.
- certificate/deshmi te leshuar nga organet e akredituara sikurse parashikon ligji nr. 15 i vitit 2017 “Per Arsimin dhe Formimin Profesional ne Republiken e Shqiperise” qe provon titullin “Dizajner” ...me anë të së cilës provohet/vërtetohet disponimi i stafit / personelit teknik nje specialist me titullin “Dizajner” të kërkuar në DST, si dhe dokumentacioni plotësues i kërkuar në DST.

Konkretisht, ne mendojmë që certificate/deshmia e leshuar, qe provon titullin “Dizajner”, nuk është lëshuar nga një organ / ent akredituar, sikurse parashikon ligji nr. 15 i vitit 2017 “Per Arsimin dhe Formimin Profesional ne Republiken e Shqiperise”. Së fundi, do të donim të parashtronim, se stafi / personeli teknik “nje specialist me titullin dizajner”, i deklaruar nga OE Filara shpk., nuk është i regjistruar në listëpagesat e këtij operatori ekonomik, me kodet korresponduese përkatëse, sipas profesioneve të kërkuara në DST, objekt ankese, dhe në përputhje me kodet e listës kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 514, datë 20.09.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”. Rrjedhimisht, përsa i përket këtij kriteri teknik / profesional. Bazuar në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, si dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST, OE Filara shpk do të duhet të skualifikohet.

Së gjashti, ne kemi bindjen, që OE Filara shpk., në kundërshtim me pikën 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, nuk disponon “pajisjet / makinerit” e nevojshme për zbatimin e kontratës, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Në pikën 2.3.5 “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST përcaktohet se: “Operatori ekonomik pjesëmarrës ne rast se do te jete vete prodhues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Makinë shtypi 50 x70 4 C ose me përmasa më të mëdha
- Makineri te posacme per kryerjen e procesit te llakimit
- Makinë qepse me pe me permasa 35x25
- Makinë prerje me permasa 80x110

- Makine qepese me tel
- Thikë një anëshe

Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.

Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjetër të fitimit të pronësive sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjetër disponimi të njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjetër të fitimit të pronësive sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjetër disponimi të njohur nga ligji). Në rast se operatori ekonomik do të sigurojë mallrat objekt i këtij prokurimi nga prodhues të tjerë duhet të paraqesë autorizim prodhuesi i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në rast se do të jete vete prodhues.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin). Shprehim bindjen tonë se OE Filara shpk nuk disponon pajisjet e kërkuara në DST për realizimin e procedurës prokuruese:

- makinë qepse me pe me permasa 35 x 25.
- makinë prerje me permasa 80 x 110.

Nga ana tjetër, ne kemi bindjen që OE Filara shpk nuk ka paraqitur edhe dokumentacionin e nevojshëm ligjor të kërkuar në DST, me anë të së cilit të provojë / vërtetojë disponimin e pajisjeve / makinerive të sipërcituara.

Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Filara shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik (si skedë teknike, manual, etj.), që të vërtetojë / provojë, se disponon makinerinë / pajisjen “makinë qepse me pe me permasa/format 35 x 25”. OE Filara shpk. Mund të disponojë 1 (një) makinë / pajisje “makinë qepse me pe”, por ne jemi të sigurtë që OE Filara shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik (si skedë teknike, manual, etj.), që të vërtetojë / provojë, se kjo makinë / pajisje është e përmasave / formatit 35 x 25 cm. Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Filara shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik (si skedë teknike, manual, etj.), që të vërtetojë / provojë, se disponon makinerinë / pajisjen “makinë prerje me permasa 80 x 110”. Edhe përsa i përket kësaj makinerie/pajisje, OE Filara shpk mund të disponojë 1 (një) makinë / pajisje “makinë prerje”, por ne jemi të sigurtë që OE Filara shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik (si skedë teknike, manual, etj.), që të vërtetojë / provojë, se kjo

makinë / pajisje është e përmasave / formatit 80 x 110 cm. Për këtë arsye, dhe në përmbushje të pikës 2.3.5 “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në cdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara më sipër... kërkojmë nga KSHA e AK Operatori i Blerjeve të Përqendruara dhe Komisioni i Prokurimit Publik verifikimin / kontrollin në vend pranë ambienteve të OE Filara shpk. Të disponimit fizik të pajisjeve të kërkuara në DST. Rrjedhimisht, edhe përsa i përket këtij kriteri teknik, bazuar në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, si dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST, OE Filara shpk do të duhet të skualifikohet.

Për të gjitha sa u parashtruan mësipër, KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik do të duhet të:

- *Ndryshojë vendimin e marrë nga KVO e AK Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.*
- *Skualifikojë operatorët ekonomikë: Filara shpk.*
- *Si dhe të shpallë fitues të procedurës së prokurimit të lartpërmendur, operatorin ekonomik Inpress shpk.*

II.17. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1256/1 datë 19.05.2025, me kriteret kualifikuese për të cilat pretendohet nga ana e ankimuesit se nuk përmbushen nga ana e operatori ekonomik “Filara” SHPK.

II.18. Në datë 21.05.2025, Komisioni Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 684/2025, për Korrigjimin e Formularit për Publikim Nr. Prot., 1256/1 datë 19.05.2025.

II.19. Me datë 22.05.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është protokolluar shkresa me nr. 1256/5 prot., datë 23.05.2025 e operatorit ekonomik “Filara” SHPK i cili ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar në procedurën e prokurimit të sipërpërmendur, nëpërmjetë shërbimit postar.

II.20. Nëpërmjet shkresës nr. 4711/3 prot, datë 26.05.2025 me objekt “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 1256/6 prot, datë 26.05.2025 (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.21. Nëpërmjet shkresës me nr. 1256/7 prot., datë 03.06.2025, me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhenie informacionit dhe dokumentacionit KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Inpress SHPK”, Komisioni Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.22. Njëpërmjet shkresës nr. 5331/1 prot, datë 04.06.2025 me objekt “*Dërgim dokumentacioni për operatorin ekonomik Filara SHPK*” protokolluar me tonën me nr. 1256/8 prot, datë 09.06.2025 është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacioni i kërkuar njëpërmjet shkresës nr. 1256/7 prot., datë 03.06.2025, në total 538 faqe.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Kristalina KH*” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit vlerësimit të ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “*Inpress*” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “*Së pari OE Filara nuk plotëson pikën 2.3.1 në kriteret e veçanta të kualifikimit e cila kërkon si më poshtë: 2.3.1 për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. Sipas pikës së mësipërme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e furnizimeve të mëparshme duhet të përfaqësojë të paktën 35% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës., Vlera e fondit limit është 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) (Monedha) leke pa TVSH, që do të thotë se operatori duhet të paraqesë dokumentacion për furnizime të realizuara me vlerë minimale prej 7,857,125.5, një vlerë e cila jemi të bindur që operatori ekonomik Filara nuk e plotëson”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.1 “*Kapaciteti teknik*” e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.1.2. Në shtojcën 6 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*”, të dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Specifikimet teknike të materialeve të arkivës:

- 1. Kuti kartoni 40 x 28 x 18 cm. Materiali që do të përdoret do të jetë karton i ngurtë me permasa 78x109, 1 paprere, me peshe 2000 gr/m². Do të ketë dy kapake, të gjitha këndet do të jenë 90 grade, të gjitha brinjët do të lidhen me beze. Kjo veshje behet për të siguruar ngjytjen. Kutia të jetë me suprinë 80 gr/m² me ngjyrë. Vendoset edhe një lidhëse për terheqje.*
- 2. Dosje të shtypura me Format 50x70 sipas skicës me karton 350 gr. Permasat 37x26 cm me llape 18 cm me dy llapa të palosura (me gjerësi 6.5 cm secila në një trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjytje, me logon e OSHEE Group të shtypur me 5C (4C + ngjyrë special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. 0*
- 3. Dosje të shtypura me Format 50x70 sipas skicës me karton 350 gr. Permasat 33x25.5 cm me llape 10 cm me dy llapa të palosura (me gjerësi 6.5 cm secila në një trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjytje me logon e OSHEE Group të shtypur me 5C (4C + ngjyrë special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skicës nr 3)*

4. *Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 22x32 cm me llape 9 cm me dy llapa te palosura dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 4)*
5. *Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve ne arkive me leter kimike 1,2 me nurmer serie, blloqe me 100 flete, ne format A4, me logon e OSHEE Group.*
6. *Regjister dhenie- marrje dokumentashne format A3, me leter 80 gr/m2me logon e OSHEE Group.*
7. *Etiketa per kuti per arkiven qendrore (formati 14x19 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
8. *Etiketa per kuti per arkiven e rretheve (formati 14x9 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
9. *Formular dorezim materialesh ne arkive me leter 80 gr offset, format A4 me logon e OSHEE Group me 5C + llak.*
10. *Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave me format 25x35 cm. Faqet e brendshme me leter offset 80 gr/m2. me 200 faqe, me qepje me pe. Te shtypet ne format 50x70 ose 70x100 ku te formohet fashikulli me 8 faqe ose me 16 faqe ne menyre qe te realizohet qepja. Kapaku te behet me punim special me karton 1500 gr/m2, me qafallare dhe me fjongo. Kapaku te mbeshillet me suprine me leter 170 gr/m2 e cila te jete e shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + boje special pantone orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
11. *Fletehyrje e perkohshme ne arkive (format A4 me leter 80 gr/m2 e ndare ne mes, me birosje, blloqe me 100 flete)me logon e OSHEE Group.*
12. *Kuti me lidhese me karton 700 gr/m2 me lidhese me suprine me beze me shpine 10 cm me permasa 23x33.*
13. *Fletepalosje A4 me leter 170 gr/m2te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
14. *Fletepalosje 20x21 leter 170 gr/m2m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne*

dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).

15. *Postera 40x58 me leter adezive 200 gr/m2 m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*

16. *Postera 50x70 me leter adezive 200 gr/m2 m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të më sipër cituar, operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

Faturë nr. 166/2024, datë 30.12.2024, Faturë nr. 205/2022, datë 21.09.2022, Faturë nr. 308/2022, datë 19.12.2022, Faturë nr. 111/2022, datë 24.06.2022, Faturë nr. 55/2023, datë 15.04.2023, Faturë nr. 142/2023, datë 03.11.2023, Faturë nr. 129/2023, datë 11.10.2023, Faturë nr. 82/2023, datë 08.06.2023, Faturë nr. 140/2024, datë 04.11.2024, Faturë nr. 137/2024, datë 29.10.2024, Faturë nr. 136/2024, datë 28.10.2024, Faturë nr. 135/2024, datë 28.10.2024, Faturë nr. 134/2024, datë 25.10.2024, Faturë nr. 133/2024, datë 24.10.2024, Faturë nr. 131/2024, datë 24.10.2024, Faturë nr. 132/2024, datë 24.10.2024, Faturë nr. 130/2024, datë 23.10.2024, Faturë nr. 129/2024, datë 22.10.2024, Faturë nr. 128/2024, datë 22.10.2024, Faturë nr. 127/2024, datë 22.10.2024, Faturë nr. 126/2024, datë 21.10.2024, Faturë nr. 124/2024, datë 15.10.2024, Faturë nr. 40/2023, datë 21.03.2023, Faturë nr. 39/2023, datë 21.03.2023, Faturë nr. 96/2024, datë 02.09.2024, Faturë nr. 320/2022, datë 23.12.2022, Faturë nr. 153/2022, datë 29.08.2022, Faturë nr. 27/2022, datë 08.02.2022, Faturë nr. 15/2022, datë 21.01.2022, Faturë nr. 14/2022, datë 20.01.2022, Faturë nr. 13/2022, datë 19.01.2022, Faturë nr. 12/2022, datë 18.01.2022, Faturë nr. 11/2022, datë 17.01.2022, Faturë nr. 9/2022, datë 14.01.2022, Faturë nr. 5/2022, datë 11.01.2022, Faturë nr. 156/2022, datë 29.08.2022, Faturë nr. 139/2021, datë 31.12.2021, Faturë nr. 154/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 155/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 153/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 152/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 160/2024, datë 20.12.2024, Faturë nr. 50/2023, datë 11.04.2023, Faturë nr. 9/2024, datë 06.02.2024, Faturë nr. 34/2024, datë 05.04.2024, Faturë nr. 23/2024, datë 18.03.2024, Faturë nr. 144/2024, datë 06.11.2023, Faturë nr. 98/2023, datë 09.08.2023, Faturë nr. 164/2023, datë 23.11.2023, Faturë nr. 93/2023, datë 24.07.2023, Faturë nr. 144/2023, datë 06.11.2023, Faturë nr. 156/2023, datë 13.11.2023, Faturë nr. 166/2023, datë 30.11.2023, Faturë nr. 174/2023, datë 15.12.2023, Faturë nr. 181/2023, datë 28.12.2023, Faturë nr. 182/2023, datë 28.12.2023, Faturë nr. 131/2023, datë 13.10.2023.

Faturë nr. 160/2022, datë 01.09.2022, Faturë nr. 225/2022, datë 03.10.2022, Faturë nr. 252/2022, datë 26.10.2022, Faturë nr. 279/2022, datë 22.11.2022, Faturë nr. 74/2022, datë 01.06.2022, Faturë nr. 54/2022, datë 04.05.2022, Faturë nr. 31/2022, datë 01.03.2022, Faturë nr. 23/2022, datë 01.02.2022, Faturë nr. 140/2021, datë 31.12.2021, Faturë nr. 159/2024, datë 20.12.2024, Faturë nr. 23/2023, datë 16.02.2023, Faturë nr. 6/2023, datë 11.01.2023, Faturë nr. 141/2023, datë 02.11.2023, Faturë nr. 87/2023, datë 27.06.2023, Faturë nr. 36/2023, datë

13.03.2023, Faturë nr. 26/2022, datë 04.02.2022, Faturë nr. 41/2022, datë 01.04.2022, Faturë nr. 77/2022, datë 03.06.2022, Faturë nr. 117/2022, datë 06.07.2022, Faturë nr. 133/2022, datë 29.07.2022, Faturë nr. 162/2022, datë 01.09.2022, Faturë nr. 268/2022, datë 08.11.2022, Faturë nr. 116/2021, datë 22.11.2021, Faturë nr. 132/2021, datë 17.12.2021, Faturë nr. 124/2021, datë 13.12.2021, Faturë nr. 124/2021, datë 13.12.2021, Faturë nr. 13/2021, datë 07.07.2021, Faturë nr. 53/2021, datë 15.09.2021, Faturë nr. 89/2021, datë 22.10.2021, Faturë nr. 8/2021, datë 05.05.2021, Faturë nr. 18/2025, datë 19.02.2025, Faturë nr. 14/2025, datë 14.02.2025, Faturë nr. 18/2025, datë 19.02.2025, Faturë nr. 14/2025, datë 14.02.2025, Faturë nr. 63/2023, datë 02.05.2023, Faturë nr. 155/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 153/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 132/2021, datë 17.12.2021, Faturë nr. 125/2021, datë 13.12.2021, Faturë nr. 134/2021, datë 20.12.2021, Faturë nr. 118/2021, datë 02.12.2021, Faturë nr. 115/2021, datë 19.11.2021, Faturë nr. 114/2021, datë 19.11.2021, Faturë nr. 38/2021, datë 31.08.2021, Faturë nr. 34/2021, datë 28.08.2021, Faturë nr. 71/2022, datë 30.05.2022.

III.1.4. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.5. Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë

pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin *“dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara. b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.”* KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik “Inpress” SHPK, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar shtojcës 8/2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mallrat objekt - prokurimi dhe sasinë respektive të tyre. KPP gjykon, se në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit, lidhet me blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a ku përfshihen artikuj 1- *Kuti kartoni (40x28x18)*; 2- *Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 37x26*; 3- *Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 33x25.5*; 4- *Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 22x32*; 5- *Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve*; 6- *Regjister dhenie- marrje dokumentash*; 7- *Etiketa per kuti per arkiven qendrore*; 8- *Etiketa per kuti per arkivat e rretheve*; 9- *Formular dorezim materialesh ne arkive*; 10- *Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave*; 11- *Fletehyrje e perkohshme ne arkive*, 12- *Kuti me lidhese me karton*; 13- *Fletepalosje A4*; 14- *Fletepalosje 20x21*; 15- *Postera 40x58*; 16- *Postera 50x70*.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit*

të kontratës.”. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmime për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra, ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes, ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më pak se 40 % e vlerës së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

III.1.10. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike, KPP vëren, se ky operator ekonomik në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me dëshmit për furnizime të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ka dorëzuar faturat e listuara në pikën III.1.3 të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i faturave të sipërcituar, të paraqitura nga ky operator ekonomik, në përmbushje të kriterit për furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, nga krahasimi i elementëve si koha e realizimit të faturave të dorëzuara, elementit ngjashmëri të faturave (referuar zërave në faturat tatimore të paraqitura me zërat e prokuruar nga autoriteti kontraktor në kontratën objekt shqyrtimi), si dhe elementit vlerë të faturave të deklaruara, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmime të furnizimeve të ngjashme të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat e autoritetit kontraktor, rezulton se në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit që kërkon të realizojë autoriteti kontraktor ka parashikuar mallrat si vijon 1- *Kuti kartoni (40x28x18)*; 2- *Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 37x26*; 3- *Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 33x25.5*; 4- *Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 22x32*; 5- *Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve*; 6- *Regjister dhenie- marrje dokumentash*; 7- *Etiketa per kuti per arkiven qendrore*; 8- *Etiketa per kuti per arkivat e rretheve*; 9- *Formular dorezim materialesh ne arkive*; 10- *Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave*; 11- *Fletehyrje e perkohshme ne arkive*, 12- *Kuti me lidhese me karton*; 13- *Fletepalosje A4*; 14- *Fletepalosje 20x21*; 15- *Postera 40x58*; 16- *Postera 50x70*. Nga krahasimi i faturave tatimore të shitjes të dorëzuara

nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, me formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik, parë kjo në rrafshin krahasimor me formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë vetëm ato fatura të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjecar nga data e njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave, faturës ose faturave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra, në një vlerë jo më të vogël se 35% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të faturave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike). KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur nga përshkrimi i mallrave në faturat tatimore, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha faturat tatimore të shitjes të dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim këto fatura të ngarkuara në PDF në sistemin e prokurimit elektronik: Faturë nr. 166/2024, datë 30.12.2024, Faturë nr. 205/2022, datë 21.09.2022, Faturë nr. 308/2022, datë 19.12.2022, Faturë nr. 111/2022, datë 24.06.2022, Faturë nr. 55/2023, datë 15.04.2023, Faturë nr. 142/2023, datë 03.11.2023, Faturë nr. 129/2023, datë 11.10.2023, Faturë nr. 82/2023, datë 08.06.2023, Faturë nr. 140/2024, datë 04.11.2024, Faturë nr. 137/2024, datë 29.10.2024, Faturë nr. 136/2024, datë 28.10.2024, Faturë nr. 135/2024, datë 28.10.2024, Faturë nr. 134/2024, datë 25.10.2024, Faturë nr. 133/2024, datë 24.10.2024, Faturë nr. 131/2024, datë 24.10.2024, Faturë nr. 132/2024, datë 24.10.2024, Faturë nr. 130/2024, datë 23.10.2024, Faturë nr. 129/2024, datë 22.10.2024, Faturë nr. 128/2024, datë 22.10.2024, Faturë nr. 127/2024, datë 22.10.2024, Faturë nr. 126/2024, datë 21.10.2024, Faturë nr. 124/2024, datë 15.10.2024, Faturë nr. 40/2023, datë 21.03.2023, Faturë nr. 39/2023, datë 21.03.2023, Faturë nr. 96/2024, datë 02.09.2024, Faturë nr. 320/2022, datë 23.12.2022, Faturë nr. 153/2022, datë 29.08.2022, Faturë nr. 27/2022, datë 08.02.2022, Faturë nr. 15/2022, datë 21.01.2022, Faturë nr. 14/2022, datë 20.01.2022, Faturë nr. 13/2022, datë 19.01.2022, Faturë nr. 12/2022, datë 18.01.2022, Faturë nr. 11/2022, datë 17.01.2022, Faturë nr. 9/2022, datë 14.01.2022, Faturë nr. 5/2022, datë 11.01.2022, Faturë nr. 156/2022, datë 29.08.2022, Faturë nr. 139/2021, datë 31.12.2021, Faturë nr. 154/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 155/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 153/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 152/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 160/2024, datë 20.12.2024, Faturë nr. 50/2023, datë 11.04.2023, Faturë nr. 9/2024, datë 06.02.2024, Faturë nr. 34/2024, datë 05.04.2024, Faturë nr. 23/2024, datë 18.03.2024, Faturë nr. 144/2024, datë 06.11.2023, Faturë nr. 98/2023, datë 09.08.2023, Faturë nr. 164/2023, datë 23.11.2023, Faturë nr. 93/2023, datë 24.07.2023, Faturë nr. 144/2023, datë 06.11.2023, Faturë nr. 156/2023, datë 13.11.2023, Faturë nr. 166/2023, datë 30.11.2023, Faturë nr. 174/2023, datë 15.12.2023, Faturë nr. 181/2023, datë 28.12.2023, Faturë nr. 182/2023, datë 28.12.2023, Faturë nr. 131/2023, datë 13.10.2023.

Faturë nr. 160/2022, datë 01.09.2022, Faturë nr. 225/2022, datë 03.10.2022, Faturë nr. 252/2022, datë 26.10.2022, Faturë nr. 279/2022, datë 22.11.2022, Faturë nr. 74/2022, datë 01.06.2022, Faturë nr. 54/2022, datë 04.05.2022, Faturë nr. 31/2022, datë 01.03.2022, Faturë nr. 23/2022, datë 01.02.2022, Faturë nr. 140/2021, datë 31.12.2021, Faturë nr. 159/2024, datë 20.12.2024, Faturë nr. 23/2023, datë 16.02.2023, Faturë nr. 6/2023, datë 11.01.2023, Faturë nr. 141/2023, datë 02.11.2023, Faturë nr. 87/2023, datë 27.06.2023, Faturë nr. 36/2023, datë 13.03.2023, Faturë nr. 26/2022, datë 04.02.2022, Faturë nr. 41/2022, datë 01.04.2022, Faturë nr. 77/2022, datë 03.06.2022, Faturë nr. 117/2022, datë 06.07.2022, Faturë nr. 133/2022, datë 29.07.2022, Faturë nr. 162/2022, datë 01.09.2022, Faturë nr. 268/2022, datë 08.11.2022, Faturë nr. 116/2021, datë 22.11.2021, Faturë nr. 132/2021, datë 17.12.2021, Faturë nr. 124/2021, datë 13.12.2021, Faturë nr. 124/2021, datë 13.12.2021, Faturë nr. 13/2021, datë 07.07.2021, Faturë nr. 53/2021, datë 15.09.2021, Faturë nr. 89/2021, datë 22.10.2021, Faturë nr. 8/2021, datë 05.05.2021, Faturë nr. 18/2025, datë 19.02.2025, Faturë nr. 14/2025, datë 14.02.2025, Faturë nr. 18/2025, datë 19.02.2025, Faturë nr. 14/2025, datë 14.02.2025, Faturë nr. 63/2023, datë 02.05.2023, Faturë nr. 155/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 153/2024, datë 16.12.2024, Faturë nr. 132/2021, datë 17.12.2021, Faturë nr. 125/2021, datë 13.12.2021, Faturë nr. 134/2021, datë 20.12.2021, Faturë nr. 118/2021, datë 02.12.2021, Faturë nr. 115/2021, datë 19.11.2021, Faturë nr. 114/2021, datë 19.11.2021, Faturë nr. 38/2021, datë 31.08.2021, Faturë nr. 34/2021, datë 28.08.2021, Faturë nr. 71/2022, datë 30.05.2022, Komisioni Prokurimit Publik shqyrtoi në themel faturat e sipërcituara, dhe konstatoi se këto fatura i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brënda afatit tre vjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm me faturat tatimore të dorëzuara me zërat e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Nga përllogaritja e faturave tatimore të paraqitura nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, rezulton se janë në vlerën XXXXXXXX lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet kontratë në një vlerë jo më të vogël se 35% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit. Sa më sipër, nga përllogaritjet e kryera nga Komisioni për faturat e ngjashme të marrë në shqyrtim rezulton, se vlera e përgjithshme e furnizimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është XXXXXXXX lekë pa TVSH, duke kaluar vlerën prej 7,857,126 lekë pa TVSH që duhet të plotësonte ky operator. Për sa më lartë kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumentave standarte të tenderit do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK. Sa më lart, nga verifikimi i furnizimeve të ngjashme të realizuara dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, të paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka kryer shërbime të ngjashme me zërat në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi

por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, nga përlllogaritja e vlerës së furnizimeve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, vlera e përgjithshme e furnizimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është XXXXXXXX lekë pa TVSH, pra arrin të kalojë vlerën prej 7,857,126 lekë pa TVSH, vlerë e cila është e barazvlefshme me kërkesën e autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit në të cilën kërkohet jo më pak se 35 % e fondit limit. Nga verifikimi i zërave të ngjashme në faturat tatimore të kontratave të paraqitura nga ankimuesi si eksperiencia të ngjashme të mëparshme, nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, emërimit/përshkrimit, me zërat në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik ka arritur të dëshmojë se ka kryer kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, pra ka arritur të dëshmojë këtë realizm duke përmbushur dhe vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit të dorëzuar si më sipërcituar dëshmon, se ka kryer furnizime të ngjashme me zërat e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi duke dëshmuar se disponon eksperiencën e nevojshme për objektin e prokurimit. Komponentët e sipërcituar të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi kanë eksperiencë të ngjashme me ato të dëshmuara nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK me anë të faturave të sipërcituara, pasi dhe vetë tipologjia e tyre është e ngjashme, referuar specifikimeve teknike dhe formularit të sasisë dhe grafikut të lëvrimit.

Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë furnizimi, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie**. Në rastin konkret, pavarësisht se faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues janë fatura furnizimi me objekte të gjera veprimtarie, në zbatimin e këtyre faturave ka mjaftueshëm zëra të ngjashme në natyrë dhe metodologji me zërat furnizimit objekt-prokurimi, dhe pasi veçoi zërat e mallrave që mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, si më sipër cituar, vëren se, nga përlllogaritja zërat e ngjashëm në faturat e paraqitura nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK jo vetëm që e përmbush por edhe e tejkalon vlerën e parashikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit. Nga shqyrtimi i fakteve dhe provave Komisioni konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “Inpress” SHPK arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Kristalina KH” SHPK nuk qëndron

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kristalina KH” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit vlerësimit të ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: Së

dyti në Shtojce Nr.1 Per Modifikimin e Dokumentave te Tenderit 2 në pikën 2.3.5 të modifikuar të Kapaciteteve Teknike në dokumenta tenderit kërkohet: 2.3.5.Operatori ekonomik pjesëmarrës ne rast se do te jete vete prodhues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: - Makinë shtypi 50 x 70 4 C ose me përmasa më të mëdha; - Makineri te posacme per kryerjen e procesit te llakimit; - Makinë qepse me pe me permasa 35 x 25; - Makinë prerje me permasa 80 x 110; - Makine qepese me tel; - Thikë një anëshe; Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha. Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji). Ne rast se operatori ekonomik do ti siguroje mallrat objekt i ketij prokurim nga prodhues te tjere duhet te paraqese autorizim prodhuesi i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ne rast se do te jete vete prodhues. Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 ipër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikë i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin). Kemi bindjen se operatori ekonomikë Inpress nuk disponon makinë prerje me permasa 80 x 110 dhe makineri qepse me penj sipas formatit te percaktuar ne DST. Ne baze te dokumentave te marre nga nje procedure gjyqesore me subjekt ata, kemi dokumentacionin qe ata disponojne qepese me penj pa asnje format, si cdo dokumentacion te paplote qe disponon OE Inpress. Kjo krijon një hendek të rëndësishëm në kapacitetin e tyre për të përmbushur detyrimet e kontratës si edhe një deklaram të rremë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për disponimin e këtyre makinerive. Ndaj kërkojmë nga AK dhe KPP verifikimin e faturave/kontratave të qirasë e kesaj makinerie të deklaruar nga ky OE që të korrespondojnë me pershkrimin dhe formatin e kërkuar.”, Komisioni Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1 Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” e modifikuar e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës ne rast se do te jete vete prodhues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Makinë shtypi 50 x70 4 C ose me përmasa më të mëdha
 - Makineri te posacme per kryerjen e procesit te llakimit
 - Makinë qepse me pe me permasa 35x25
 - Makinë prerje me permasa 80x110
 - Makine qepese me tel
 - Thikë një anëshe
- Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.
 - Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënës (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji).
 - Ne rast se operatori ekonomik do ti siguroje mallrat objekt i ketij prokurim nga prodhues te tjere duhet te paraqese autorizim prodhuesi i cili duhet të përmbajë të dhena të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëebsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ne rast se do te jete vete prodhues.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

III.2.2. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 1/a në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9.

III.2.3. Në shtojcën 6 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*”, të dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Specifikimet teknike të materialeve të arkivës:

- 1. Kuti kartoni 40 x 28 x 18 cm. Materiali që do të perdoret do të jete karton i ngurte me permasa 78x109, I paprere, me peshe 2000 gr/m². Do të kete dy kapake, të gjitha kendet do të jene 90 grade, të gjitha brinjet do të lidhen me beze. Kjo veshje behet për të siguruar ngjitjen. Kutia të jete me suprine 80 gr/m² me ngjyre. Vendoset edhe një lidhese për terheqje.*
- 2. Dosje të shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 37x26 cm me llape 18 cm me dy llapa të palosura (me gjerësi 6.5 cm secila në një trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje, me logon e OSHEE Group të shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. 0*
- 3. Dosje të shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 33x25.5 cm me llape 10 cm me dy llapa të palosura (me gjerësi 6.5 cm secila në një trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group të shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 3)*
- 4. Dosje të shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 22x32 cm me llape 9 cm me dy llapa të palosura dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group të shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 4)*
- 5. Flete procesverbal mbi dorezimin e të dhenave dhe materialeve në arkive me leter kimike 1,2 me numër serie, blloqe me 100 flete, në format A4, me logon e OSHEE Group.*
- 6. Regjister dhenie- marrje dokumentash në format A3, me leter 80 gr/m² me logon e OSHEE Group.*
- 7. Etiketa për kuti për arkiven qendrore (formati 14x19 me logon e OSHEE Group me leter adezive) të shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
- 8. Etiketa për kuti për arkiven e rretheve (formati 14x9 me logon e OSHEE Group me leter adezive) të shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*

9. *Formular dorezim materialesh ne arkive me leter 80 gr offset, format A4 me logon e OSHEE Group me 5C + llak.*
10. *Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave me format 25x35 cm. Faqet e brendshme me leter offset 80 gr/m2. me 200 faqe, me qepje me pe. Te shtypet ne format 50x70 ose 70x100 ku te formohet fashikulli me 8 faqe ose me 16 faqe ne menyre qe te realizohet qepja. Kapaku te behet me punim special me karton 1500 gr/m2, me qafallare dhe me fjongo. Kapaku te mbeshtillet me suprine me leter 170 gr/m2 e cila te jete e shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + boje special pantone orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
11. *Fletehyrje e perkohshme ne arkive (format A4 me leter 80 gr/m2 e ndare ne mes, me birosje, blloqe me 100 flete) me logon e OSHEE Group.*
12. *Kuti me lidhese me karton 700 gr/m2 me lidhese me suprine me beze me shpine 10 cm me permasa 23x33.*
13. *Fletepalosje A4 me leter 170 gr/m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
14. *Fletepalosje 20x21 leter 170 gr/m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
15. *Postera 40x58 me leter adezive 200 gr/m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
16. *Postera 50x70 me leter adezive 200 gr/m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*


III.2.4. Në përmbushje të kriterit të më sipër cituar, operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Inpress” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshëm për realizimin e objektit të kontratës” operatori ekonomik “Inpress” SHPK deklaron:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [✓] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 17 (shtatëmbëdhjetë) Profili i punonjësve <u>OE Inpress shpk., deklaron se:</u> për realizimin e kësaj kontrate disponon një staf punonjësish prej minimalisht 5 persona per muajin e fundit te maturuar në datën e hapjes së ofertave. <u>OE Inpress shpk., deklaron se:</u> ka të punësuar një punonjës të specializuar në profesionin "<u>dizajner</u>". — <u>Makineri e mjete</u> Po [✓] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

	✓ Makinë shtypi 50 x70 4 C ose me përmasa më të mëdha - Pronësi ✓ Makineri të posacme për kryerjen e procesit te llakimit - Qira ✓ Makinë qepse me pe me permasa 35x25- Pronësi ✓ Makinë prerje me permasa 80x110 - Qira ✓ Makinë qepese me tel- Pronësi ✓ Thikë një anëshe- Pronësi
Emri, Mbiemri <i>Erald Dermishi</i> Firma <i>Erald Dermishi</i> Vula  Data e dorëzimit të deklaratës 25.03.2025	

III.2.5. Komisoni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr.738/2025, datë 03.06.2025 vendosi:

1- Të urdhërojnë paraqitjen e dokumentacionit original ose kopje e noterizuar të tyre, nga ana e operatorit ekonomik "Inpress" Shpk, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-34415- 12-23-2024 me objekt: "Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a", me fond limit 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (dyqind e njëzet e shtate mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 25.03.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

2- Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 12.06.2025.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.2.6. Në zbatim të vendimit Nr. 738/2025, datë 03.06.2025, operatori ekonomik "Inpress" SHPK në datën 11.05.2025 nëpërmjet shkresës me objekt "Dorëzohet dokumentacioni kualifikues, në mbështetje të vetëdeklarimeve të paraqitura nga operatori ekonomik Inpress shpk" protokolluar me tonën me nr. 1251/9 prot, datë 11.06.2025 ka depozituar dokumentacioni e kërkuar nëpërmjet vendimit nr. 738/2025., datë 03.06.2025, në total 728 faqe. Referuar dokumenteve Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterëve për kualifikim, 2.3.2 dhe 2.3.3 (për të cilat ankimuesi ngre pretendime) janë paraqitur dokumentet si vijon:

- Faturë tatimore shitje me nr. serial xxxxxxxxx, datë xxxxxxxxx, lëshuar nga subjekti "xxxxxxxxxxxxxxxx" sh.p.k për subjektin "Inpress" sh.p.k, me objekt: "Makinë xxxxxxxxx", bashkalidhur fotot e makinerisë, shoqëruar me vërtetim noterial "Njësie me origjinalin" nr. 4744 Rep, datë 10.06.2025.
- Faturë tatimore shitje me nr. xxxxxxx, datë xxxxxxxxx, lëshuar nga subjekti "xxxxxxx" sh.p.k për subjektin "Inpress" sh.p.k, me objekt: "Makinë xxxxxxxxxxxxxxxxxxx", bashkalidhur fotot e makinerisë, shoqëruar me vërtetim noterial "Njësie me origjinalin" nr. 4744 Rep, datë 10.06.2025.
- Faturë tatimore shitje me nr. xxxxxx, datë xxxxxxx, lëshuar nga subjekti "xxxxxxx" sh.p.k për subjektin "Inpress" sh.p.k, me objekt: "Makinë xxxxxxxxxxx", shoqëruar me vërtetim noterial "Njësie me origjinalin" nr. 4744 Rep, datë 10.06.2025.
- Kontratë Qeraje datë xxxxxxxxx me Nr. xxxxx Rep, Nr. xxxxxx Kol me qeradhënës subjektin "xxxxxxx" sh.p.k dhe qeramarrës subjektin "Inpress" sh.p.k, me objekt: "Makinë xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx", bashkalidhur deklarata doganore, shoqëruar me vërtetim noterial "Njësie me origjinalin" nr. 4744 Rep, datë 10.06.2025.

- *Vendim nr. XXXXXX Dosje/Nr. xxxxxx Prot, datë xxxxxxxx, e përmbaruesit gjyqësor z. A. M në cilësinë e përmbaruesit gjyqësor pranë shoqërisë së përmbarimit “Bailiff Services Matani & Co” SHPK, i cili ka vendosur ndër të tjera :*

“1. Të kalojë pronësinë e sendeve të luajtshme

Makineri XXXXXXXXXXXXXXXX

Nga shoqëria debitoare “A. B. C” shpk në favor të blerësit shoqëria “Inpress” shpk me Nipt: L52122014L, i cili nga ky moment bëhet pronar i sendeve të luajtshme edhe sikur këto sende të mos ishin në pronësinë e debitorit.”, shoqëruar me faturë tatimore shitje me numër serial nr; xxxxxxxx, datë xxxxxxxx lëshuar nga subjekti “Bailiff Services Matani & Co” SHPK për subjektin “Inpress” SHPK, me vlerë xxxxxxxx leke pa-TVSH dhe mandat arketimi nr. xxxx, datë xxxxxxxx, si dhe shoqëruar me vërtetim noterial “Njësie me origjinalin” nr. 4744 Rep, datë 10.06.2025.

III.2.7. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.2.8. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.9. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.10. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 2 dhe pika 5 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.2.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.12. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues që të kualifikohen për këtë kriter kualifikues, duhet të dëshmojnë se kanë në pronësi ose me qera pajisjet si në vijim: *“Makinë shtypi 50 x70 4 C ose me përmasa më të mëdha; Makineri te posacme per kryerjen e procesit te llakimit; Makinë qepse me pe me permasa 35x25; Makinë prerje me permasa 80 x 110; Makinë qepese me tel; Thikë një anëshe. Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.”*, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit si në vijim: *“Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësine e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji). Ne rast se operatori ekonomik do ti siguroje mallrat objekt i ketij prokurim nga prodhues te tjere duhet te paraqese autorizim prodhuesi i cili duhet të permbajë të dhena të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”* Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “Inpress” ShPK, konstatohet, se ky i fundit për pretendimet e ngritura nga ankimesi ka paraqitur

dokumentacionin për disponimin e mjeteve të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur, ku vërtetohet së ka në pronësi dhe me qera pajisjet si në vijim: “*Makine qepjeje me penjë, me faturë tatimore shitje me nr. serial XXXXXX, datë XXXXXX, lëshuar nga subjekti “XXXXXX” sh.p.k për subjektin “Inpress” sh.p.k, bashkalidhur fotot e makinerisë, shoqëruar me vërtetim noterial “Njësie me origjinalin” nr. 4744 Rep, datë 10.06.2025*”. “*Makine qepse me pe e përmasave të mëdha, me faturë tatimore shitje me nr. XXXXXX, datë XXXXXX, lëshuar nga subjekti “XXXXXX” sh.p.k për subjektin “Inpress” sh.p.k, bashkalidhur fotot e makinerisë, shoqëruar me vërtetim noterial “Njësie me origjinalin” nr. 4744 Rep, datë 10.06.2025*”. “*Makine Prerëse të Përmasave të Mëdha XXXXXXXX, me faturë tatimore shitje me nr. XXXXX, datë XXXXXX, lëshuar nga subjekti “XXXXXX” sh.p.k për subjektin “Inpress” sh.p.k, shoqëruar me vërtetim noterial “Njësie me origjinalin” nr. 4744 Rep, datë 10.06.2025*”. “*Makinë prerëse e formateve të mëdha format XXXXXX cm e markës Eöhlenberg, model 180, me numër serie nr. XXXXX, me kontratë qeraje datë XXXXXXXX me Nr. XXXX Rep, Nr. XXXX Kol me qeradhënës subjektin “XXXXXX” sh.p.k dhe qeramarrës subjektin “Inpress” sh.p.k, bashkalidhur deklarata doganore, shoqëruar me vërtetim noterial “Njësie me origjinalin” nr. 4744 Rep, datë 10.06.2025*”. “*Makineri prerëse dhe mbledhëse XXXXXXXX, me fatura tatimore blerje, dhe Vendim nr. XXX Dosje/Nr. XXXX Prot, datë XXXXX, e përmbaruesit gjyqësor z. A. M në cilësinë e përmbaruesit gjyqësor pranë shoqërisë së përmbarimit “Bailiff Services Matani & Co” SHPK, i cili ka vendosur ndër të tjera të kalojë pronësinë e sendeve të luajtshme makinerinë e sipërcituar në emër të shoqërisë “Inpress” SHPK*”.

Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit sa i takon mjeteve të kërkuar, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Inpress” SHPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të Shtojcës 8/2 të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Pra, në rastin konkret KPP gjykon, se operatori ekonomik “Inpress” SHPK me dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe dokumentacionin e dorëzuar pranë KPP, përmbush kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit në lidhje me makineritë.

Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në ofertën e tij “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” ku në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme ka deklaruar, se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç

përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin e ka paraqitur për përmbushjen e kriterit 2.3.5 të përcaktuar në DST. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit sikurse përmendëm edhe më sipër, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë skedë teknike, manual, për vërtetimin e përmasave të makinerive gjithashtu, referuar DST, autoriteti Kontraktor nuk ka përcaktuar në asnjë moment verifikimin / kontrollin në vend pranë ambienteve të operatoreve ekonomik kërkesë e cila do të përbënte detyrim për t'u përmbushur nga ofertuesit, ndërkohë operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar "*Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit*", duke deklaruar mjetet, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, në përputhje me kërkesat e AK të parashikuara në shtojcën 8/2, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 1, gërma "a" sipas të cilit: "Ofertuesi duhet të paraqesë Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9", dhe dokumentacionin provues në formë shkresore lidhur me kriterin e kërkuar. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cenon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Gjithashtu, Vlen të theksojmë, se në çdo rast është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, që në momentin e marrjes në dorëzim të mallit/shërbimit objekt - prokurimi, të kërkojë nga operatori ekonomik që të vërtetojë përmbushjen e kërkesave dhe specifikimeve teknik. Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 "*Sigurimi i ofertës*" i Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenet 36 "*Sigurimi i kontratës*", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 "*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*" të LPP, si dhe nenit 107 "*Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës*" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes "*Kristalina KH*" SHPK për operatorin ekonomik "*Inpress*" SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "*Kristalina KH*" SHPK ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "*Filara*" SHPK., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë

që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Inpress” SHPK përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukseesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar. Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

III.3.1. Parashikimi i nenit 110 e vijues të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

III.3.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.3.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës, për sa kohë që përpara tij me vlerë më të ulët vijon të qëndrojë i kualifikuar një operator ekonomik edhe pas ankesës së bërë prej tij. Pra, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka se si të dëmtohet nga sukseesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Pasi për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve mbi s’kualifikimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, të palës ankimuese, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoi se këto të fundit nuk qëndrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 25.04.2025 dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Inpress”, SHPK do të vijojë të mbetet i kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për s’kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Filara” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tij, për këtë operator ekonomik pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Kristalina KH*” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit vlerësimit të ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “*Albdesign PSP*” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “*sipas dokumentacionit të bërë publik, oferta e paraqitur nga OE “Albdesign PSP” sh.p.k ka një vlerë prej 23,427,360 lekë me TVSH, ndërkohë që fondi limit i përcaktuar për këtë procedurë është 22,448,930 lekë. Pranimi i kësaj oferte cënon parimet e barazisë, konkurrencës së ndershme dhe barazisë së trajtimit të operatorëve ekonomikë, ndaj me skualifikimin e kësaj oferte, oferta e OE Filara do të dilte tashme oferte anomalisht e ulët.*”, Komisioni Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 1 të dokumenteve të tenderit, rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t’i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;

¹ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

III.4.2. Nga verifikimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK ka dorëzuar:

- 1- Shtojcën 1 “Formularin e ofertës”, të plotësuar dhe nënshkruar;
- 2- Shtojcën 2 “Lista e cmimeve”, të plotësuar dhe të nënshkruar

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹

Data: 25.03.2025

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: REF-34415-12-23-2024

Për: [Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [ALBDESIGN PSP SH.P.K , L51819005Q]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: [Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- b) Ne [ALBDESIGN PSP SH.P.K , L51819005Q] , nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a].
- c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor [Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [Materiale të ndryshme të shtypura,] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: 19,522,800 LEKE [nentemdhjetemilion e pesëqinde njezete e dy mijë e teteqind leke];

Ë Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 23,427,360 LEKE [njetete e tremilion e katerqind e njetete e shtate mije e treqind e gjashtedhjetë leke];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	ERVIN RRUSHI
Nënshkrimi	
Vula	 Rr. Çerçiz Topulli, 17 - Kashar, Tiranë NIP: L51819005Q
Datë	25.03.2025

III.4.3 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.4.4. Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.4.5. Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.4.6. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.4.7. Në nenin 91 “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Pas afatit përfundimtar për hapjen e ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit për vlerën e ofertës, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t’i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdolloj mënyre ofertën.

3. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 të këtij ligji.

III.4.8. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.4.9. Në nenin 82 pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se: “3. *Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:*

Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;*
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe*
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

3.Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin .

b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

III.4.10. *Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kërkesave dhe kushteve për t’u plotësuar nga ofertuesit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesat e vendosura. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.*

III.4.11. Sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se referuar shtojcës 1 “Formulari i Ofertës Ekonomik”, të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK, rezulton, se vlera e ofertuar është 19 522 800 lekë pa TVSH nga ku përlllogaritja e së cilës del nga vlera e zërave të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e TVSH vlera e ofertuar është 23 427 360 lekë me TVSH. Ndërkohë që në formularin e ofertës sipas shojcës 1 të DST çmimi total i ofertës pa TVSH është deklaruar 19 522 800 lekë pa TVSH dhe me TVSH është deklaruar 23 427 360 lekë me TVSH. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nuk ndodhemi para gabimeve aritmetike në kuptim të nenit 82 pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nga ku nëse do të ishim përballë një fakti të tillë, autoritetit kontraktor i lind detyrimi që të kryejë veprimet procedurale gjatë konstatimit të këtij gabimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi në rast të konstatimeve të tilla. Gjithashtu nga verifikimi i fondit limit të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor për këtë procedurë rezulton se është në vlerën 22 448 930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) leke pa TVSH. Komisioni gjykon, se oferta e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK është më e ulët se fondi limit i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi. Argumenti i dhënë nga ankimuesi se vlera e ofertës së operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK është mbi fondin limit nuk qëndron pasi ky operator ekonomik ak ofertuar në vlerën 19 522 800 lekë pa TVSH në formularin e ofertës dhe është në përputhje me fondin limit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Kristalina KH” SHPK, nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit vlerësimit të ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Filara” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: “Në kundërshtim me gjurmën “e”, të pikës 3, të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe të shtojcës 8, Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit të DST, ...Operatori ekonomik Filara shpk. Ndodhet në kushtet e skualifikimit të detyrueshëm, pasi “...Operatori ekonomik Filara shpk. Ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka cuar në përfundimin e kësaj kontrate”. Në gjurmën “e”, të pikës 3, të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, përcaktohet: “3. cdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: e) Operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka cuar në përfundimin e kësaj kontrate”. Në :Formularin e Njoftim Fituesit”, të publikuar në faqen zyrtare të APP-së, në datë 20.08.2024, nga AK Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës, referuar një tjetër procedure prokuruese REF-11465-06-28-2024, “Blerje diploma - marrëveshje kuadër për 24 muaj”, përcaktohet: “...3. Operatori Ekonomik “Filara” shpk, me NUIS K51611059N, me ofertë ekonomike 2.185.600 (dy milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH dhe 2.622.720 (dy milion e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e

shtatëqind e njëzet) lekë me TVSH ndodhet në kushtet e skualifikimit për arsye se është në kushtet detyruese për skualifikim parashikuar në gërmën e të pikës 3 të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “3. cdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncensionare që ka cuar në përfundimin e kësaj kontrate. Ky kusht i referohet marrëdhënies kontraktuale të mëparshme, jo të suksesshme që ka patur me Autoritetin Kontraktor Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, duke mospërmbushur kontratën e nënshkruar me Nr. 256/30, datë 04.12.2023 me objekt: “Loti 5 Blerje libra per bibliotekën e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës”, si dhe amendimit të kontratës me Nr.216/2 Prot., datë 31.01.2024 me Kontraktuesin “Filara” shpk, të cilën është dërguar “njoftim për ndërprerje kontrate për mospërmbushje, me Nr.216/8 Prot., datë 27.02.2024, si dhe Raportimi mbi mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale, drejtuar Agjensisë së Prokurimit Publik, me Nr.216/10 Prot., datë 08.03.2024. Nisur nga ky fakt, bazuar në shkresën me Nr.1315 Prot., datë 18.07.2024, me lëndë: “Kërkesë për sqarim”, drejtuar Agjensisë së Prokurimit Publik, si dhe në shkresën me Nr.5227/1 Prot., datë 26.07.2024, Kthim përgjigje nga Agjencia e Prokurimit Publik, protokolluar në Institucion me Nr.1315/1Prot., datë 01.08.2024, komisioni i vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave rivlerësoi procedurën e prokurimit duke skualifikuar operatorin ekonomik “Filara” shpk, në zbatim të parashikimit ligjor të sipërcituar. Nisur nga sa mësipër, gjykojmë se AK OSHEE Group sh.a. do të duhet të skualifikojë OE Filara shpk., pasi ky operator ekonomik ndodhet në kushtet e skualifikimit të detyrueshëm, bazuar në gërmën “e”, të pikës 3, të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Pra, nuk është e mundur, që një Autoritet Kontraktor (Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës), pas korrespondencës me Agjencinë e Prokurimit Publik, e skualifikon OE Filara shpk., ndërsa një Autoritet tjetër Kontraktor (OSHEE Group sh.a.) e kualifikon OE Filara shpk. Rrjedhimisht, do të kërkonim nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara se të marrin një vendim të arsyetuar në lidhje me këtë pikë të kësaj ankese, të marrin një informacion zyrtar me shkrim nga Agjencia e Prokurimit Publik, mbi statusin e OE Filara shpk., si dhe nëse një procedurë audituese / hetuese ka nisur apo jo ndaj këtij operatori ekonomik. Bashkëlidhur, gjeni “Formularin e Njoftim Fituesin”, të publikuar në faqen zyrtare të APP-së, në datë 20.08.2024, nga AK Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.5.2 Në nenin 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raportin në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.5.3 Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK dhe dokumentacionit bashkëlidhur ne ankese ku citohet se Autoriteti Kontraktor Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës e ka skualifikuar kete operator ekonomik ne nje procedure duke cituar se “3. Operatori Ekonomik “Filara” shpk, me NUIS K51611059N, me ofertë ekonomike 2.185.600 (dy milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH dhe 2.622.720 (dy milion e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e njëzet) lekë me TVSH ndodhet në kushtet e skualifikimit për arsye se është në kushtet detyruese për skualifikim parashikuar në germën e të pikës 3 te nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “3. cdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncensionare që ka cuar në përfundimin e kësaj kontrate. Ky kusht i referohet marrëdhënies kontraktuale të mëparshme, jo të suksesshme që ka patur me Autoritetin Kontraktor Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, duke mospërmbushur kontratën e nënshkruar me Nr. 256/30, datë 04.12.2023 me objekt: “Loti 5 Blerje libra per bibliotekën e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës”, si dhe amendimit të kontratës me Nr.216/2 Prot., datë 31.01.2024 me Kontraktuesin “Filara” shpk, të cilën është dërguar “njoftim për ndërprerje kontrate për mospërmbushje, me Nr.216/8 Prot., datë 27.02.2024, si dhe Raportimi mbi mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale, drejtuar Agjensisë së Prokurimit Publik, me Nr.216/10 Prot., datë 08.03.2024. Nisur nga ky fakt, bazuar në shkresën me Nr.1315 Prot., datë 18.07.2024, me lëndë: “Kërkesë për sqarim”, drejtuar Agjensisë së Prokurimit Publik, si dhe në shkresën me Nr.5227/1 Prot., datë 26.07.2024, Kthim përgjigje nga Agjencia e Prokurimit Publik, protokolluar në Institucion me Nr.1315/1Prot., datë 01.08.2024, komisioni i vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave rivleresoi

procedurën e prokurimit duke skualifikuar operatorin ekonomik “Filara” shpk, në zbatim të parashikimit ligjor të sipërcituar. Nisur nga sa mësipër, gjykojmë se AK OSHEE Group sh.a. do të duhet të skualifikojë OE Filara shpk., pasi ky operator ekonomik ndodhet në kushtet e skualifikimit të detyrueshëm, bazuar në gërmën “e”, të pikës 3, të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Pra, nuk është e mundur, që një Autoritet Kontraktor (Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës), pas korrespondencës me Agjencinë e Prokurimit Publik, e skualifikon OE Filara shpk., ndërsa një Autoritet tjetër Kontraktor (OSHEE Group sh.a.) e kualifikon OE Filara shpk. Rrjedhimisht, do të kërkonim nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara se të marrin një vendim të arsyetuar në lidhje me këtë pikë të kësaj ankese, të marrin një informacion zyrtar me shkrim nga Agjencia e Prokurimit Publik, mbi statusin e OE Filara shpk., si dhe nëse një procedurë audituese / hetuese ka nisur apo jo ndaj këtij operatori ekonomik. Bashkëlidhur, gjeni “Formularin e Njoftim Fituesin”, të publikuar në faqen zyrtare të APP-së, në datë 20.08.2024, nga AK Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës. [...]

III.5.4. Në interpretim të dispozitës ligjore të sipërcituar, del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë për të ankimuar çdo lloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor, i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi i ankesës të paraqitur nga ankimuesi konstatohet, se ky i fundit kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Filara” nga procedura e prokurimit objekt-ankimi. Nga verifikimi i kryer në Buletinin e Njoftimeve Publike lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se nga kontrolli i kryer në Buletinet nga data ku i është dërguar raportimi lidhur me “Njoftimin për nderprerje kontrate për mos përmbushje kjo drejtuar APP me datë 08.03.2024, deri me sot, rezulton se operatori ekonomik “Filara” SHPK nuk është i përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik, në interpretim të nenit 94 të ligjit nr.162/2020, gjykon se del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë për të ankimuar çdo lloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor, i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi i ankesës të paraqitur nga ankimuesi konstatohet, se ky i fundit kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Filara” SHPK nga procedura e prokurimit objekt – ankimi, për shkak se ky operator është në kundërshtim me gërmën “e” të pikës “3” të nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, por nga verifikimet e kryera operatori ekonomik “Filara” SHPK nuk rezulton të ketë qenë apo të jetë i përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, pra nuk kemi një vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik për përjashtim të tij, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Pra për sa kohë autoriteti kompetent për përjashtimin nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik (Agjencia e Prokurimit Publik) nuk ka dalë me një vendim për përjashtim, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Filara” SHPK nuk është në cilësinë për përjashtim nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Sa me sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Filara” SHPK me arsyetimin se: “[...] operatori ekonomik Filara shpk. NUK ka në objektin e veprimtarisë së tij tregtare, objekt e prokurimit publik iblerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a, si dhe NUK ka në objektin e veprimtarisë së tij tregtare “prodhimin apo tregtimin” e asnjë prej mallrave / produkteve / artikujve si: “kuti kartoni, dosje kartoni të llojeve të ndryshme, etj”, të cilat zenë mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve / artikujve të kërkuar në DST. Objekti i plotë i veprimtarisë tregtare i OE Filara shpk është si mëposhtë: “Shtepi Botuese, botime te ndryshme, artistike, letrare, shkollore, universitare dhe botimeve te monografive shkencore ne fushen e albanologjise. Shtypshkronje, shtypshkrime me element sigurie, fletepalosje, agjenda, flyer, katalog, kartevizita, banera, postera, roll up, kalendar muri, kalendar tavoline, canta, revista, letra me koke, blloqe recetash, stilolapsa me logo, broshura, zarfa, etiketa, etj. Agjenci trajnimesh per zhvillimin e vazhduar profesional, trajnimin dhe certifikimin e punonjesve arsimor, trajnime te ndryshme. Tregtim kancelarish te ndryshem, mjete didaktike mesimore, produkte te ndryshme per arte dhe zeje. Organizim eventesh, dekore, festa dhe materiale promocionale te ndryshme. Printime dixhitale te te gjithave llojeve te reklamave dhe tabelave, logime, brandime, video promocionale, gjenerim platforme dixhitale, zhvillim dhe menaxhim aplikacioni ëebi, etj”. - përfundon këtu / ekstrakt historik i shoqërisë tregtare Filara shpk / datë 14.05.2025. Sic mund të vihet re lehtësisht, në objektin e veprimtarisë tregtare të OE Filara shpk mungon plotësisht objekti i prokurimit publik “Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”, si dhe mungon plotësisht veprimtaria tregtare e “prodhimit apo tregtimit të mallrave / produkteve / artikujve si: kuti kartoni, dosje kartoni të llojeve të ndryshme, etj., të cilat zenë mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve / artikujve të kërkuar në DST”. Kjo mungesë është mëse normale përse i përket OE Filara shpk., pasi ky operator ekonomik nuk është as prodhues dhe as tregtues i “materialeve të arkivës”, dhe mallrave / produkteve / artikujve kuti kartoni dhe dosje kartoni, etj. Ne kemi bindjen (duke njohur mirë tregun e prodhimit dhe tregtimit të materialeve të arkivës (si: kuti kartoni dhe dosje kartoni, etj.), që OE Filara shpk. NUK ka në objektin e veprimtarisë së tij tregtare mallrat / materialet objekt prokurimi, pasi nuk i ka prodhuar apo tregtuar asnjëherë më parë (nuk ka eksperiencë / punë të ngjashme “intro”). Përse mësipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të fushës së prokurimit publik, gjykojmë se është e papranueshme (për të mos thënë skandaloze), që KVO e AK ka kualifikuar OE Filara shpk., për aq kohë sa në veprimtarinë tregtare të OE Filara shpk. Nuk ekziston objekti i prokurimit publik, si dhe “prodhimi apo tregtimi” i mallrave / produkteve / artikujve si: kuti kartoni, dosje kartoni të llojeve të ndryshme, etj., të cilat zenë mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve / artikujve të kërkuar në DST. Rrjedhimisht, KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik “KPP”, do të duhet të ndryshojnë vendimin e KVO së AK, dhe të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik [...]” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “a” e dokumentare të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; [...]

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

III.6.2. Në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, Pjesa II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>

III.6.3. Në përmbushje të kriterit të më sipër cituar, operatori ekonomik “Filara” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Inpress” SHPK, ku në Pjesën II: “ka dorëzuar: 1. “Formularin e vetëdeklarimit”, ku në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit” është deklaruar si vijon:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme.</i> Dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike si më poshtë: <i>Adresën e Web-it: www.e-albania.al</i> <i>Autoritetin ose organin lëshues: Qendra Kombëtare e Biznesit</i> <i>Lloji i dokumentit: Ekstrakt I Thjeshtë</i> Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Dokumentacioni përkatës është i disponueshëm si më poshtë: <i>Autoritetin ose organin lëshues: Gjykata e Rethit Gjyqësor Tirane</i> <i>Lloji i dokumentit: Vertetim</i>

III.6.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.6.5. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.6.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.***

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve² të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V,

² Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike³. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.6.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i

ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: **“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”**

III.6.8. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai bazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, bazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ka për detyrë *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

III.6.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për sa i përket objektit të veprimtarisë së shoqërisë “Filara” SHPK, gjykojmë se kriteri në lidhje me objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues “Filara” SHPK, në përputhje me objektin e procedurës objekt ankimi, është një kërkesë e cila bën pjesë tek kriteret e përgjithshme të kualifikimit, ku referuar përcaktimeve në dokumentet e tenderit këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” SHPK rezulton se për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9. Gjithashtu, nga verifikimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Filara” SHPK, i publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se objekti i aktivitetit të shoqërisë “Filara” SHPK është përcaktuar: *“Shtepi Botuese, botime të ndryshme, artistike, letrare, shkollore, universitare dhe botimeve të monografive shkencore në fushën e albanologjisë. Shtypshkronje, shtypshkrime me element sigurie, fletpalosje, agenda, flyer, katalog, kartvizita, banera, postera, roll up, kalendar muri, kalendar tavoline, canta, revista, letra me*

koke, blloqe recetash, stilolapsa me logo, broshura, zarfa, etiketa, etj. Agjenci trajnimesh per zhvillimin e vazhduar profesional, trajnimin dhe certifikimin e punonjesve arsimor, trajnime te ndryshme. Tregtim kancelarish te ndryshem, mjete didaktike mesimore, produkte te ndryshme per arte dhe zeje. Organizim eventesh, dekore, festa dhe materiale promociionale te ndryshme. Printime dixhitale te te gjithave llojeve te reklamave dhe tabelave, logime, brandime, video promociionale, gjenerim platforme dixhitale, zhvillim dhe menaxhim aplikacioni ëebi, etj". Gjithashtu referuar dokumentave standarte të tenderit konkretisht seksionit 2 "Objekti Kontratës" pika 2.2 "Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)", rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar "Materiale të ndryshme të shtypura, e cila korespondon me kodin CPV 22900000-9". Referuar faqes zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në seksionin "Të tjera", në rubrikën "Kodet CPV" përcaktohen grupi i kodeve, emërtimi i kodit CPV dhe Identifikimi i kodit CPV për procedurat e prokurimit elektronik. Sa më sipër, në grupin e kodeve "Materiale të stampuara dhe produkte të lidhura me to" bën pjesë emërtimi i kodit 22900000-9 dhe identifikimi i kodit *Materiale të ndryshme të shtypura*, i cili përputhet me objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Filara" SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, ku deklarohet se ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë "Filara" SHPK, sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar si më sipër cituar rezulton i përfshirë edhe kodi CPV i përzgjedhur nga autoriteti kontraktor.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Inpress" SHPK nuk qëndron

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Inpress" SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit vlerësimit të ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik "Filara" SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: "operatori ekonomik Filara shpk. NUK ka asnjë eksperiencë / punë të ngjashme për prodhimin dhe / ose tregtimin e ëmaterialeve të arkivësë si: kuti kartoni, dosje kartoni, etj., të cilat zenë mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve të kërkuara në objektin dhe DST e prokurimit publik, objekt ankese. Në pikën 2.3.1. "Kapaciteti Teknik", të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, përcaktohet: 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisitë e mallrave të furnizuara. b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Vlera e fondit limit i procedurës prokuruese objekt ankese është: 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) leke pa TVSH. 35% e vlerës së fondit limit është: 7,857,125.5 (shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e pesë presje pesë) lekë pa TVSH. Vlera e faturave për eksperiencat / punët e ngjashme që do të duhet të paraqesin operatorët ekonomikë pjesëmarrës për mallrat / produktet / materialet e arkivës si: kuti kartoni, dosje kartoni, etj., (të cilat zenë realisht mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve / materialeve të kërkuara në DST, por për qëllime thjeshtëzimi po marrim si të mirëqenë se zenë vetëm 90% të volumit të mallrave të kërkuara), është minimalisht: 7,071,413 (shtatë milion e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH. Duke njohur shumë mirë tregun shqiptar të prodhimit dhe tregtimit të mallrave / produkteve / materialeve të arkivës, si kuti kartoni, dosje kartoni, etj., ne kemi bindjen se OE Filara shpk. Nuk ka paraqitur pranë AK OSHEE Group sh.a faturat me anë të së cilës të vërtetojë / provojë eksperiencën / punën e ngjashme për prodhimin dhe/ose tregtimin e mallrave / produkteve / materialeve të arkivës, si kuti kartoni, dosje kartoni, etj., në vlerën minimalisht të: 7,071,413 (shtatë milion e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH. Dihet botërisht, që OE Filara shpk nuk është as prodhues dhe as tregtues i mallrave / produkteve / materialeve të arkivës, si kuti kartoni, dosje kartoni, etj. Rrjedhimisht, nuk është e mundur që OE Filara shpk të ketë lëshuar fatura tatimore për shitjen e produkteve të lartërmendura, kur ky operator ekonomik nuk është as prodhues dhe as tregtues. Përveç OE Filara shpk., të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokuruese, janë ose prodhues dhe/ose tregtues të mallrave / produkteve / materialeve të arkivës, si kuti kartoni, dosje kartoni, etj. Përsa mësipër, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nenligjore të fushës së prokurimit publik, gjykojmë se është e papranueshme (për të mos thënë skandaloze), që KVO e AK ka kualifikuar OE Filara shpk., për aq kohë sa OE Filara shpk nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm teknik (fatura tatimore / vërtetim / kontrata), me anë të së cilës të vërtetojë / provojë eksperiencën e ngjashme për “prodhimin dhe/ose tregtimin e mallrave / produkteve / artikujve si: kuti kartoni, dosje kartoni të llojeve të ndryshme, etj., të cilat zenë mbi 95% të volumit të mallrave / produkteve / artikujve të kërkuar në DST”. Rrjedhimisht, KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik “KPP”, do të duhet të ndryshojnë vendimin e KVO së AK, dhe të konsiderojnë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” shpk., duke e skualifikuar këtë operator ekonomik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- d) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.7.2. Në shtojcën 6 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*”, të dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Specifikimet teknike të materialeve të arkivës:

- 1. Kuti kartoni 40 x 28 x 18 cm. Materiali që do të përdoret do të jetë karton i ngurtë me permasa 78x109, lëvizës, me peshë 2000 gr/m². Do të ketë dy kapake, të gjitha këndet do të jenë 90 gradë, të gjitha brinjët do të lidhen me beze. Kjo veshje behet për të siguruar ngjitjen. Kutia të jetë me suprinë 80 gr/m² me ngjyrë. Vendoset edhe një lidhëse për terheqje.*
- 2. Dosje të shtypura me Format 50x70 sipas skicës me karton 350 gr. Permasat 37x26 cm me llapë 18 cm me dy llapa të palosura (me gjerësi 6.5 cm secila në një trup pa prerje) dhe pjesa balllore me kthim pa ngjitje, me logon e OSHEE Group të shtypur me 5C (4C + ngjyrë special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. 0*
- 3. Dosje të shtypura me Format 50x70 sipas skicës me karton 350 gr. Permasat 33x25.5 cm me llapë 10 cm me dy llapa të palosura (me gjerësi 6.5 cm secila në një trup pa prerje) dhe pjesa balllore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group të shtypur me 5C (4C + ngjyrë special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skicës nr 3)*
- 4. Dosje të shtypura me Format 50x70 sipas skicës me karton 350 gr. Permasat 22x32 cm me llapë 9 cm me dy llapa të palosura dhe pjesa balllore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group të shtypur me 5C (4C + ngjyrë special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skicës nr 4)*

5. *Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve ne arkive me leter kimike 1,2 me nurmer serie, blloqe me 100 flete, ne format A4, me logon e OSHEE Group.*
6. *Regjister dhenie- marrje dokumentashne format A3, me leter 80 gr/m2me logon e OSHEE Group.*
7. *Etiketa per kuti per arkiven qendrore (formati 14x19 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
8. *Etiketa per kuti per arkiven e rretheve (formati 14x9 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
9. *Formular dorezim materialesh ne arkive me leter 80 gr offset, format A4 me logon e OSHEE Group me 5C + llak.*
10. *Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave me format 25x35 cm. Faqet e brendshme me leter offset 80 gr/m2. me 200 faqe, me qepje me pe. Te shtypet ne format 50x70 ose 70x100 ku te formohet fashikulli me 8 faqe ose me 16 faqe ne menyre qe te realizohet qepja. Kapaku te behet me punim special me karton 1500 gr/m2, me qafallare dhe me fjongo. Kapaku te mbeshillet me suprine me leter 170 gr/m2 e cila te jete e shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + boje special pantone orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
11. *Fletehyrje e perkohshme ne arkive (format A4 me leter 80 gr/m2 e ndare ne mes, me birosje, blloqe me 100 flete)me logon e OSHEE Group.*
12. *Kuti me lidhese me karton 700 gr/m2 me lidhese me suprine me beze me shpine 10 cm me permasa 23x33.*
13. *Fletepalosje A4 me leter 170 gr/m2te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
14. *Fletepalosje 20x21 leter 170 gr/m2m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
15. *Postera 40x58 me leter adezive 200 gr/m2m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne*

dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).

16. *Postera 50x70 me leter adezive 200 gr/m2 m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*

III.7.3. Në përmbushje të kriterit të më sipër cituar, operatori ekonomik “Filara” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

Faturë nr. 180/2022, datë 20.12.2022, Faturë nr. 131/2023, datë 16.10.2023, Faturë nr. 218/2023, datë 15.12.2023, Faturë nr. 39/2023, datë 15.08.2023, Faturë nr. 160/2023, datë 25.10.2023, Faturë nr. 21/2023, datë 30.06.2023, Faturë nr. 23/2023, datë 10.07.2023, Faturë nr. 83/2023, datë 18.09.2023, Faturë nr. 17/2023, datë 15.06.2023, Faturë nr. 85/2024, datë 12.07.2024, Faturë nr. 120/2024, datë 06.09.2024, Faturë nr. 19/2024, datë 26.02.2024, Faturë nr. 8/2024, datë 29.01.2024, Faturë nr. 33/2024, datë 12.04.2024, Faturë nr. 92/2024, datë 29.07.2024, Faturë nr. 50/2024, datë 16.05.2024, Faturë nr. 70/2024, datë 20.06.2024, Faturë nr. 71/2024, datë 26.06.2024, Faturë nr. 115/2024, datë 29.08.2024, Faturë nr. 143/2024, datë 16.09.2024, Faturë nr. 99/2024, datë 20.08.2024, Faturë nr. 276/2024, datë 19.12.2024, Faturë nr. 12/2024, datë 29.07.2024, Faturë nr. 130/2024, datë 11.09.2024, Faturë nr. 192/2024, datë 11.10.2024, Faturë nr. 49/2024, datë 15.05.2024, Faturë nr. 43/2024, datë 02.05.2024, Faturë nr. 87/2024, datë 15.07.2024, Faturë nr. 311/2024, datë 26.12.2024, Faturë nr. 30/2023, datë 01.08.2023, Faturë nr. 134/2023, datë 17.10.2023, Faturë nr. 56/2024, datë 27.05.2024.

Faturë nr. 87/2024, datë 15.07.2024, Faturë nr. 56/2024, datë 27.05.2024, Faturë nr. 50/2024, datë 16.05.2024, Faturë nr. 71/2024, datë 26.06.2024, Faturë nr. 70/2024, datë 20.06.2024, Faturë nr. 17/2023, datë 15.06.2023, Faturë nr. 115/2024, datë 29.08.2024, Faturë nr. 71/2024, datë 26.06.2024, Faturë nr. 83/2023, datë 18.09.2023, Faturë nr. 19/2024, datë 26.02.2024, Faturë nr. 311/2024, datë 26.12.2024.

III.7.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.7.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose*

dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.7.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.7.7. Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat,

shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.7.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.7.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin *“dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”* KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik “Filara” SHPK, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar shtojcës 8/2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mallrat objekt - prokurimi dhe sasi të respektive të tyre. KPP gjykon, se në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit, lidhet me blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a ku përfshihen artikuj 1- Kuti kartoni (40x28x18); 2- Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 37x26; 3- Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 33x25.5; 4- Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 22x32; 5- Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve; 6- Regjister dhenie- marrje dokumentash; 7- Etiketa per kuti per

arkiven qendrore; 8- Etiketa per kuti per arkivat e rretheve; 9- Formular dorezim materialesh ne arkive; 10- Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave; 11- Fletehyrje e perkohshme ne arkive, 12- Kutu me lidhese me karton; 13- Fletepalosje A4; 14- Fletepalosje 20x21; 15- Postera 40x58; 16- Postera 50x70.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmimeve për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra, ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes, ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më pak se 40 % e vlerës së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

III.7.10. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Filara” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike, KPP vëren, se ky operator ekonomik në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me dëshmit për furnizime të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ka dorëzuar faturat e listuara në pikën III.6.3 të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i faturave të sipërcituar, të paraqitur nga ky operator ekonomik, në përmbushje të kriterit për furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, nga krahasimi i elementëve si koha e

realizimit të faturave të dorëzuara, elementit ngjashmëri të faturave (referuar zërave në faturat tatimore të paraqitura me zërat e prokuruar nga autoriteti kontraktor në kontratën objekt shqyrtimi), si dhe elementit vlerë të faturave të deklaruara, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të furnizimeve të ngjashme të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat e autoritetit kontraktor, rezulton se në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit që kërkon të realizojë autoriteti kontraktor ka parashikuar mallrat si vijon 1- Kuti kartoni (40x28x18); 2- Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 37x26; 3- Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 33x25.5; 4- Dosje te shtypura me Format 50x70, përmasa 22x32; 5- Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve; 6- Regjister dhenie- marrje dokumentash; 7- Etiketa per kuti per arkiven qendrore; 8- Etiketa per kuti per arkivat e rretheve; 9- Formular dorezim materialesh ne arkive; 10- Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave; 11- Fletehyrje e perkohshme ne arkive, 12- Kuti me lidhese me karton; 13- Fletepalosje A4; 14- Fletepalosje 20x21; 15- Postera 40x58; 16- Postera 50x70. Nga krahasimi i faturave tatimore të shitjes të dorëzuara nga operatori ekonomik “Filara” SHPK, me formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt prokurimi, KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik, parë kjo në rrafshin krahasimor me formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë vetëm ato fatura të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjecar nga data e njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave, faturës ose faturave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra, në një vlerë jo më të vogël se 35% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të faturave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Filara” SHPK me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike). KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të kontratave të sipërcituara, duke nisur nga përshtkrimi i mallrave në faturat tatimore, si dhe afatit të realizimit të tyre, nga të gjitha faturat tatimore të shitjes të dorëzuara në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Filara” SHPK për vërtetueshmërinë e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, mori në shqyrtim këto fatura të ngarkuara në PDF në sistemin e prokurimit elektronik: Faturë nr. 180/2022, datë 20.12.2022, Faturë nr. 131/2023, datë 16.10.2023, Faturë nr. 218/2023, datë 15.12.2023, Faturë nr. 39/2023, datë 15.08.2023, Faturë nr. 160/2023, datë 25.10.2023, Faturë nr. 21/2023, datë 30.06.2023, Faturë nr. 23/2023, datë 10.07.2023, Faturë nr. 83/2023, datë 18.09.2023, Faturë nr. 17/2023, datë 15.06.2023, Faturë nr. 85/2024, datë 12.07.2024, Faturë nr. 120/2024, datë 06.09.2024, Faturë nr. 19/2024, datë 26.02.2024, Faturë nr. 8/2024, datë 29.01.2024, Faturë nr. 33/2024, datë 12.04.2024, Faturë nr. 92/2024, datë 29.07.2024, Faturë nr. 50/2024, datë 16.05.2024, Faturë nr. 70/2024, datë 20.06.2024, Faturë nr. 71/2024, datë 26.06.2024, Faturë nr. 115/2024, datë 29.08.2024, Faturë nr. 143/2024, datë 16.09.2024, Faturë nr. 99/2024, datë 20.08.2024, Faturë nr. 276/2024, datë 19.12.2024, Faturë nr. 12/2024, datë 29.07.2024, Faturë nr. 130/2024, datë 11.09.2024, Faturë nr. 192/2024, datë 11.10.2024, Faturë nr. 49/2024, datë 15.05.2024, Faturë nr. 43/2024,

datë 02.05.2024, Faturë nr. 87/2024, datë 15.07.2024, Faturë nr. 311/2024, datë 26.12.2024, Faturë nr. 30/2023, datë 01.08.2023, Faturë nr. 134/2023, datë 17.10.2023, Faturë nr. 56/2024, datë 27.05.2024. Faturë nr. 87/2024, datë 15.07.2024, Faturë nr. 56/2024, datë 27.05.2024, Faturë nr. 50/2024, datë 16.05.2024, Faturë nr. 71/2024, datë 26.06.2024, Faturë nr. 70/2024, datë 20.06.2024, Faturë nr. 17/2023, datë 15.06.2023, Faturë nr. 115/2024, datë 29.08.2024, Faturë nr. 71/2024, datë 26.06.2024, Faturë nr. 83/2023, datë 18.09.2023, Faturë nr. 19/2024, datë 26.02.2024, Faturë nr. 311/2024, datë 26.12.2024. Komisioni Prokurimit Publik shqyrtoi në themel faturat e sipërcituara, dhe konstatoi se këto fatura i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që janë brënda afatit tre vjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm me faturat tatimore të dorëzuara me zërat e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. Nga përlllogaritja e faturave tatimore të paraqitura nga operatori ekonomik “*Filara*” SHPK, rezulton se janë në vlerën XXXXXXXX lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet kontratë në një vlerë jo më të vogël se 35% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit. Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për faturat e ngjashme të marrë në shqyrtim rezulton, se vlera e përgjithshme e furnizimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është XXXXXXXX lekë pa TVSH, duke kaluar vlerën prej 7,857,126 lekë pa TVSH që duhet të plotësonte ky operator. Për sa më lartë kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumentave standarte të tenderit do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik “*Filara*” SHPK. Sa më lart, nga verifikimi i furnizimeve të ngjashme të realizuara dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, të paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik “*Filara*” SHPK ka kryer shërbime të ngjashme me zërat në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, nga përlllogaritja e vlerës së furnizimeve të ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik “*Filara*” SHPK, vlera e përgjithshme e furnizimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga ky operator ekonomik është XXXXXXXX lekë pa TVSH, pra arrin të kalojë vlerën prej 7,857,126 lekë pa TVSH, vlerë e cila është e barazvlefshme me kërkesën e autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit në të cilën kërkohet jo më pak se 35 % e fondit limit. Nga verifikimi i zërave të ngjashme në faturat tatimore të kontratave të paraqitura nga ankimuesi si eksperiencia të ngjashme të mëparshme, nga përlllogaritja e zërave të ngjashëm për sa i përket llojit, emërimit/përshkrimit, me zërat në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit dhe specifikimet teknike të kontratës objekt shqyrtimi, rezulton se operatori ekonomik ka arritur të dëshmojë se ka kryer kontrata të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, pra ka

arritur të dëshmojë këtë realizim duke përmbushur dhe vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Sa më sipër, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik, KPP konstaton, se me anë të dokumentacionit të dorëzuar si më sipërcituar dëshmon, se ka kryer furnizime të ngashme me zërat e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi duke dëshmuar se disponon eksperiencën e nevojshme për objektin e prokurimit. Komponentët e sipërcituar të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi kanë eksperiencë të ngjashme me ato të dëshmuara nga operatori ekonomik “Filara” SHPK me anë të faturave të sipërcituara, pasi dhe vetë tipologjia e tyre është e ngjashme, referuar specifikimeve teknike dhe formularit të sasisë dhe grafikut të lëvrimit.

Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë furnizimi, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie**. Në rastin konkret, pavarësisht se faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues janë fatura furnizimi me objekte të gjera veprimtarie, në zbatimin e këtyre faturave ka mjaftueshëm zëra të ngjashme në natyrë dhe metodologji me zërat furnizimit objekt-prokurimi, dhe pasi veçoi zërat e mallrave që mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, si më sipër cituar, vëren se, nga përlllogaritja zërat e ngjashëm në faturat e paraqitura nga operatori ekonomik “Filara” SHPK jo vetëm që e përmbush por edhe e tejkalon vlerën e parashikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit. Nga shqyrtimi i fakteve dhe provave Komisioni konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “Filara” SHPK arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.1 të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndron

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Filara” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi me arsyen se: *“operatori ekonomik Filara shpk nuk disponon personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi. Në pikën 2.3.4. “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, përcaktohet: “Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij një specialist me titullin “Dizajner”. Kjo të vërtetohet me dokumentacion (diplome ne rast se specialisti ka mbaruar shkolle te larte ose certificate/deshmi te leshuar nga organet e akredituara sikurse parashikon ligji nr. 15 i vitit 2017 “Per Arsimin dhe Formimin Profesional ne Republiken e Shqiperisee qe provon titullin “Dizajner”) dhe kontratën e punës. Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe*

nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin). Në kemi bindjen që OE Filara shpk nuk disponon të personelin teknik të nevojshëm “nje specialist me titullin dizajner”, referuar objektit të prokurimit, të kërkuar në DST. Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Filara shpk nuk ka paraqitur pranë AK dokumentacionin e nevojshëm ligjor: - diplome ne rast se specialisti ka mbaruar shkolle te larte. - certificate/deshmi te leshuar nga organet e akredituara sikurse parashikon ligji nr. 15 i vitit 2017 “Per Arsimin dhe Formimin Profesional ne Republiken e Shqiperise” qe provon titullin “Dizajner” ...me anë të së cilës provohet/vërtetohet disponimi i stafit / personelit teknik nje specialist me titullin “Dizajner” të kërkuar në DST, si dhe dokumentacioni plotësues i kërkuar në DST. Konkretisht, ne mendojmë që certifikata/deshmia e leshuar, qe provon titullin “Dizajner”, nuk është lëshuar nga një organ / ent akredituar, sikurse parashikon ligji nr. 15 i vitit 2017 “Per Arsimin dhe Formimin Profesional ne Republiken e Shqiperise”. Së fundi, do të donim të parashtronim, se stafi / personeli teknik “nje specialist me titullin dizajner”, i deklaruar nga OE Filara shpk., nuk është i regjistruar në listëpagesat e këtij operatori ekonomik, me kodet korresponduese përkatëse, sipas profesioneve të kërkuara në DST, objekt ankese, dhe në përputhje me kodet e listës kombëtare të Profesioneve (LKP), të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 514, datë 20.09.2017 “Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”. Rrjedhimisht, përsa i përket këtij kriteri teknik / profesional. Bazuar në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, si dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST, OE Filara shpk do të duhet të skualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.8.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.a të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

III.8.2. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.4 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi të modifikuar është përcaktuar kriteri si më poshtë:

Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nje specialist me titullin “dizajner”.

Kjo të vërtetohet me dokumentacion (diplome ne rast se specialisti ka mbaruar shkolle te larte ose certificate/deshmi te leshuar nga organet e akredituara sikurse parashikon ligji nr. 15 i vitit 2017 “Per arsimin dhe Formimin Profesional ne Republiken e Shqiperise” qe provon titullin “dizajner”) dhe kontratën e punës.

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

III.8.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Filara” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Filara” SHPK, në të cilin në Pjesën III, B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ka deklaruar si më poshtë:

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po ☒ Jo ☐ Nëse, po, numri i punonjësve: Numri i Punonjësve për Periudhën Shkurt 2025 është 13 punonjës; <u>Profili i punonjësve</u> 1. Z. _____ me profesion Disenjator grafikësh i punësuar pranë shoqërisë sone, në rolin Disenjator grafikësh; <u>Makineri e mjete</u> Po ☒ Jo ☐ Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: 1. Makineri Shtypi min 50 X 70cm 4C, ne pronesi, vertetuar nepermjet References doganore R 33844 date 01.04.2024 2. Makineri Llakimi, ne pronesi vertetuar nepermjet Fat.Nr.58 Dt 15.08.2006; 3. Makinë qepse me pe me permasa min 35x25, ne pronesi vertetuar nepermjet Fat.Nr.124 Dt 07.12.2022; 4. Makinë prerje me permasa min 80x110 vertetuar nepermjet kontrates se qirase me nr repertori 5845 dhe nr koleksioni 3989 date 06.06.2023 me afat te pacaktuar; 5. Makineri Qepse me Tel, ne pronesi, vertetuar nepermjet Fat.Nr. 31 Dt. 17.10.2024; 6. Makineri Qepse me Tel, ne pronesi, vertetuar nepermjet Fat.Nr. 78 Dt. 30.07.2006 7. Thike njeaneshe, ne pronesi, vertetuar nepermjet Fat.Nr.78 Dt.30.07.2006;

III.8.4. Në zbatim të shkresës Nr. 1256/7, datë 03.06.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a, me shkresën nr. 5331/1 prot, datë 04.06.2025 me objekt “*Dërgim dokumentacioni për operatorin ekonomik Filara SHPK*”, protokolluar me tonën me nr. 1256/8 prot, datë 09.06.2025 ka depozituar dokumentacioni e kërkuar nëpërmjetë vendimit nr. 1256/7, datë 03.06.2025, në total 538 faqe. Referuar dokumenteve Komisioni konstaton, se në përmbushje të kriterit për kualifikim, 2.3.4 (për të cilat ankimesi ngre pretendime) janë paraqitur dokumentet si vijon:

- Kontratë Individuale Pune datë 01.04.2024 lidhur ndërmjetë punëdhënësit “*Filara*” SHPK dhe punëmarrësit “G. M”, me afat 3 vjecar, me funksion Disenjator;
- Certifikatë me nr amze 13086 për z. G. M i cili ka përfunduar kursin 9 muaj, për Design, lëshuar nga XXXXXXXXXXXXX;

III.8.5. Në nenin 2 “*Qëllimi i ligjit*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.8.6. Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr. 162/2021 “*Për prokurimin publik*” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.8.7. Në nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.8.8. Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrava”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë...*

III.8.9. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.8.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese*

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve⁴ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike⁵. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

⁴ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.8.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.6 dhe 2.3.7 kapaciteti teknik të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokument të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, *në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet*

e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues me dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, konkretisht ka deklaruar punonjës in që disponon, si dhe profilin e parashikuara në pikën 2.3.4 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, të dokumenteve të tenderit, gjithashtu autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit dokumentacion e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, si operator i kualifikuar i pari, në zbatim të përcaktimeve ligjore.

III.8.12. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet, se operatori ekonomik “Filara” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet, se operatori ekonomik “Filara” SHPK, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të secilit prej tyre, në Pjesën III, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, ka deklaruar staf in që disponon. Referuar pretendimeve të ankimuesit, konkretisht, operatori ekonomik “Filara” SHPK ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës Dizajner, konkretisht z. G. M. Duke qenë se operatori ekonomik “Filara” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, nëpërmjet shkresës me nr. 5331/1 prot., datë 04.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1256/8 prot datë 09.06.2025, me objekt “Dërgim dokumentacioni për operatorin ekonomik Filara shpk”, autoriteti kontraktor, ka paraqitur pranë KPP-së informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, si dhe dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Filara” SHPK, si operator ekonomik të kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nisur nga pretendimet e ankimuesit, konstatohet se operatori ekonomik “Filara” SHPK, në përmbushje të kriterit për punonjës in e mësipërm në dokumentet e tenderit, referuar deklarimit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për 1 (një) punonjës dizajner të pajisur me **diplome** ne rast se specialisti ka mbaruar shkolle te larte ose **certifikate/deshmi**, konkretisht, ku operatori ekonomik “Filara” SHPK, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar z. G. M, ku ka paraqitur dokumentacion (certifikatë) për një punonjës. Konkretisht: -Kontratë Individuale Pune datë 01.04.2024 lidhur ndërmjetë punëdhënësit “Filara” SHPK dhe punëmarrësit “G. M”, me afat 3 vjecar, me funksion Disenjator;

- Certifikatë me nr amze 13086 për z. G. M i cili ka përfunduar kursin 9 muaj, për Design, lëshuar nga XXXXXXXX;

Nisur nga pretendimet e ankimuesit Komisioni verifikoi dokumentacionin e sipërcituar të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik “Filara” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik ankimues, “Filara” SHPK ka paraqitur “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” dhe dokumentacion fizik për vërtetimin e deklarimeve konkretisht dhe të punonjësit të kërkuar, ndodhur përballë nevojës për të kryer verifikime të mëtejshme në lidhje me pretendimet e ankimuesit Komisioni verifikoi në faqen zyrtare të qkb.gov.al në seksionin kërko në Rregjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, në hapsirën Licencat, Lejet e lëshuara nga QKB, rezulton se subjekti (Agjensia 100% Shqip) me numr çeshtje: CN-440334-09-10, datë 15/09/2010 ndryshoi nga ishte emri subjektit (Agjensia 100% Shqip) u be emri tregtar i subjektit (VITRINA), Agjensia 100% Shqip me nipt K68503503B, është i pajisur me licencën nr. LN-1385-04-2010, me kod: X.2.B, për të ushtruar aktivitetin për formim profesional dhe pajisjen e me certifikata trajnimi punonjës për profilet (Design). Pas verifikimeve të kryera nga ana Komisionit në burime të hapura, konkretisht në faqen zyrtare të qkb.gov.al për subjektin privat (VITRINA) ish (Agjensia 100% Shqip) konstaton se, në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se punonjësi i deklaruar dhe i pajisur me certifikatë nga ky subjekt është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor pasi subjekti i sipërcituar ofron kurse të formimit profesional për (Dizajner). Për rrjedhojë operatori ekonomik ankimues “Filara” Shpk e përmbush kërkesën për kualifikim që *operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nje specialist me titullin “dizajner”. Kjo të vërtetohet me dokumentacion (diplome ne rast se specialisti ka mbaruar shkolle te larte ose certifikate/deshmi te leshuar nga organet e akredituara sikurse parashikon ligji nr. 15 i vitit 2017 “Per arsimin dhe Formimin Profesional ne Republiken e Shqiperise” qe provon titullin “dizajner”)* dhe kontratën e punës.”. Për sa më sipër argumentuar, operatori ekonomik “Filara” Shpk e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor ndaj dhe do të konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit vlerësimit të ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Filara” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: *OE Filara shpk., në kundërshtim me pikën 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, nuk disponon “pajisjet / makinerit” e nevojshme për zbatimin e kontratës, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Në pikën 2.3.5 “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST përcaktohet se: “Operatori ekonomik pjesëmarrës ne rast se do te jete vete prodhues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: - Makinë shtypi 50 x70 4 C ose me përmasa më të mëdha; - Makineri te posacme per kryerjen e procesit te llakimit; - Makinë qepse me pe me permasa 35x25; - Makinë prerje me permasa 80x110; - Makine qepese me tel*

- Thikë një anëshe; Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha. Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesis sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesis sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji). Ne rast se operatori ekonomik do ti siguroje mallrat objekt i ketij prokurim nga prodhues te tjere duhet te paraqese autorizim prodhuesi i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ne rast se do te jete vete prodhues. Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a” “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin). Shprehim bindjen tonë se OE Filara shpk nuk disponon pajisjet e kërkuara në DST për realizimin e procedurës prokuruese:

- makinë qepse me pe me permasa 35 x 25.
- makinë prerje me permasa 80 x 110.

Nga ana tjetër, ne kemi bindjen që OE Filara shpk nuk ka paraqitur edhe dokumentacionin e nevojshëm ligjor të kërkuar në DST, me anë të së cilit të provojë / vërtetojë disponimin e pajisjeve / makinerive të sipërcituara. Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Filara shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik (si skedë teknike, manual, etj.), që të vërtetojë / provojë, se disponon makinerinë / pajisjen “makinë qepse me pe me permasa/format 35 x 25”. OE Filara shpk. Mund të disponojë 1 (një) makinë / pajisje “makinë qepse me pe”, por ne jemi të sigurtë që OE Filara shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik (si skedë teknike, manual, etj.), që të vërtetojë / provojë, se kjo makinë / pajisje është e përmasave / formatit 35 x 25 cm. Gjithashtu, ne kemi bindjen që OE Filara shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik (si skedë teknike, manual, etj.), që të vërtetojë / provojë, se disponon makinerinë / pajisjen “makinë prerje me permasa 80 x 110”. Edhe përse i përket kësaj makinerie/pajisje, OE Filara shpk mund të disponojë 1 (një) makinë / pajisje “makinë prerje”, por ne jemi të sigurtë që OE Filara shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion teknik (si skedë teknike, manual, etj.), që të vërtetojë / provojë, se kjo makinë / pajisje është e përmasave / formatit 80 x 110 cm. Për këtë arsye, dhe në përmbushje të pikës 2.3.5 “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit të DST, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në cdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar më sipër... kërkojmë nga KSHA e AK Operatori i Blerjeve të Përqendruara dhe Komisioni i Prokurimit Publik verifikimin / kontrollin në vend pranë ambienteve të OE Filara shpk. Të disponimit fizik të pajisjeve të kërkuara në DST. Rrjedhimisht, edhe përse i përket këtij kriteri teknik, bazuar

në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, si dhe në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST, OE Filara shpk do të duhet të skualifikohet.”, Komisioni Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1 Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” e modifikuar e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik pjesëmarrës ne rast se do te jete vete prodhues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- *Makinë shtypi 50 x70 4 C ose me përmasa më të mëdha*
- *Makineri te posacme per kryerjen e procesit te llakimit*
- *Makinë qepse me pe me permasa 35x25*
- *Makinë prerje me permasa 80x110*
- *Makine qepese me tel*
- *Thikë një anëshe*
- *Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.*
- *Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësine e qiradhënësin (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji).*
- *Ne rast se operatori ekonomik do ti siguroje mallrat objekt i ketij prokurim nga prodhues te tjere duhet te paraqese autorizim prodhuesi i cili duhet të përmbajë të dhena të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëebsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ne rast se do te jete vete prodhues.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera*

shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin).

III.9.2. Në shtojcën 9/2 “*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*”, pika 1/a në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9.

III.9.3. Në shtojcën 6 “*Formulari i Specifikimeve Teknike*”, të dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Specifikimet teknike të materialeve të arkivës:

- 1. Kuti kartoni 40 x 28 x 18 cm. Materiali qe do te perdoret do te jete karton i ngurte me permasa 78x109, I paprere, me peshe 2000 gr/m2. Do te kete dy kapake, te gjitha kendet do te jene 90 grade, te gjitha brinjjet do te lidhen me beze. Kjo veshje behet per te siguruar ngjitjen. Kutia te jete me suprine 80 gr/m2 me ngjyre. Vendoset edhe nje lidhese per terheqje.*
- 2. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 37x26 cm me llape 18 cm me dy llapa te palosura (me gjeresi 6.5 cm secila ne nje trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje, me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. 0*
- 3. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 33x25.5 cm me llape 10 cm me dy llapa te palosura (me gjeresi 6.5 cm secila ne nje trup pa prerje) dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 3)*
- 4. Dosje te shtypura me Format 50x70 sipas skices me karton 350 gr. Permasat 22x32 cm me llape 9 cm me dy llapa te palosura dhe pjesa ballore me kthim pa ngjitje me logon e OSHEE Group te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (Sipas skices nr 4)*
- 5. Flete procesverbal mbi dorezimin e te dhenave dhe materialeve ne arkive me leter kimike 1,2 me nurmer serie, blloqe me 100 flete, ne format A4, me logon e OSHEE Group.*
- 6. Regjister dhenie- marrje dokumentashne format A3, me leter 80 gr/m2me logon e OSHEE Group.*

7. *Etiketa per kuti per arkiven qendrore (formati 14x19 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
8. *Etiketa per kuti per arkiven e rretheve (formati 14x9 me logon e OSHEE Group me leter adezive) te shtypur me 5C (4C + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
9. *Formular dorezim materialesh ne arkive me leter 80 gr offset, format A4 me logon e OSHEE Group me 5C + llak.*
10. *Regjister per dorezimin e inventareve te dokumentave me format 25x35 cm. Faqet e brendshme me leter offset 80 gr/m2. me 200 faqe, me qepje me pe. Te shtypet ne format 50x70 ose 70x100 ku te formohet fashikulli me 8 faqe ose me 16 faqe ne menyre qe te realizohet qepja. Kapaku te behet me punim special me karton 1500 gr/m2, me qafallare dhe me fjongo. Kapaku te mbeshtillet me suprine me leter 170 gr/m2 e cila te jete e shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + boje special pantone orange 021C ose ekuivalent) + llak.*
11. *Fletehyrje e perkohshme ne arkive (format A4 me leter 80 gr/m2 e ndare ne mes, me birosje, blloqe me 100 flete) me logon e OSHEE Group.*
12. *Kuti me lidhese me karton 700 gr/m2 me lidhese me suprine me beze me shpine 10 cm me permasa 23x33.*
13. *Fletepalosje A4 me leter 170 gr/m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
14. *Fletepalosje 20x21 leter 170 gr/m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
15. *Postera 40x58 me leter adezive 200 gr/m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).*
16. *Postera 50x70 me leter adezive 200 gr/m2 te shtypur me 5C (4 ngjyrat baze + ngjyre special Pantone Orange 021C ose ekuivalent) + llak. (OE fitues do ti vihen ne*

dispozicion materiale bruto te cilat pas perpunimit nga designer i OE dhe miratimit nga ana e strukturave perkatese te OSHEE Group do te futet per prodhim).

III.9.4. Në përmbushje të kriterit të më sipër cituar, operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Inpress” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshëm për realizimin e objektit të kontratës” operatori ekonomik “Filara” SHPK deklaron:

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po ☒ Jo ☐ Nëse, po, numri i punonjësve: Numri i Punonjësve për Periudhën Shkurt 2025 është 13 punonjës; <u>Profili i punonjësve</u> 1. Z. _____ me profesion Disenjator grafikësh i punësuar pranë shoqërisë sone, në rolin Disenjator grafikësh; <u>Makineri e mjete</u> Po ☒ Jo ☐ Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: 1. Makineri Shtypi min 50 X 70cm 4C, ne pronesi, vertetuar nepermjet References doganore R 33844 date 01.04.2024 2. Makineri Llakimi, ne pronesi vertetuar nepermjet Fat.Nr.58 Dt 15.08.2006; 3. Makinë qepse me pe me permasa min 35x25, ne pronesi vertetuar nepermjet Fat.Nr.124 Dt 07.12.2022; 4. Makinë prerje me permasa min 80x110 vertetuar nepermjet kontrates se qirase me nr repertori 5845 dhe nr koleksioni 3989 date 06.06.2023 me afat te pacaktuar; 5. Makineri Qepse me Tel, ne pronesi, vertetuar nepermjet Fat.Nr. 31 Dt. 17.10.2024; 6. Makineri Qepse me Tel, ne pronesi, vertetuar nepermjet Fat.Nr. 78 Dt. 30.07.2006 7. Thike njeaneshe, ne pronesi, vertetuar nepermjet Fat.Nr.78 Dt.30.07.2006;

III.9.5. Në zbatim të shkresës Nr. 1256/7, datë 03.06.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a, me shkresën nr. 5331/1 prot, datë 04.06.2025 me objekt “Dërgim dokumentacioni për operatorin ekonomik Filara SHPK”, protokolluar me tonën me nr. 1256/8 prot, datë 09.06.2025 ka depozituar dokumentacionin e kërkuar nëpërmjet vendimit nr. 1256/7, datë 03.06.2025, në total 538 faqe. Referuar dokumenteve Komisioni

konstaton, se në përmbushje të kriterit për kualifikim, 2.3.5 (për të cilat ankimuesi ngre pretendime) janë paraqitur dokumentet si vijon:

- *Faturë tatimore shitje me nr.XXXXXX, datë XXXXXX, lëshuar nga subjekti "XXXXXXXXXX" sh.p.k për subjektin "Filara" sh.p.k, me objekt: "Makine XXXXXXXX", "Njësie me origjinalin" nr. 2025 Rep, datë 28.04.2025.*
- *Kontratë Qeraje datë XXXXX me Nr. XXXXX Rep, Nr. XXXXX Kol me qeradhënës subjektin "XXXXXX" sh.p.k dhe qeramarrës subjektin "Filara" sh.p.k, në nenin 1 "Objekti i Qerasë" palët kanë rënë dakort si vijon: "Pala qiradhënëse i jep qira palës qiramarrëse makineri printimi, shtypshkrimi, sipas listës të sipërcituar dhe dokumentacionit që i bashkëngjitet kësaj kontrate, me vulë lidhëse noteriale, si më poshtë vijon".*

Makineri printimi.

Makineri për lidhje libri.

Makineri për birimin e letrës.

Makineri të tjera kallëpimi.

Makineri palosje e perorur.

Makineri printimi ofset.

Makineri prerje dhe printimi.

Makineri ngjitëse e përdorur.

Makineri tharëse e përdorur.

Makineri shtypi Roland 604 3B me 4 ngjyra, format 72 × 102.

Makineri CTP, për përgatitjen e lastrave, e përdorur.

Makineri për punime speciale të kopertinave.

III.9.6. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*".

III.9.7. Ndërkohë në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë*

ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.9.8. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.9.10. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.9.11. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 2 dhe pika 5 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.*

III.9.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.9.13. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues që të kualifikohen për këtë kriter kualifikues, duhet të dëshmojnë se kanë në pronësi ose me qera pajisjet si në vijim: “*Makinë shtypi 50 x70 4 C ose me permasa më të mëdha; Makineri te posacme per kryerjen e procesit te llakimit; Makinë qepse me pe me permasa 35x25; Makinë prerje me permasa 80 x 110; Makinë qepese me tel; Thikë një anëshe. Formatet e këtyre makinave janë formatet minimale, mund të paraqiten makina me formate më të mëdha.*”, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit si në vijim: “*Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të*

paraqesin fatura tatimore, kontrata blerje/dhurim, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënës (fatura tatimore, kontrate blerje/dhurimi, zhdoganim apo cdo forme tjeter te fitimit te pronesise sipas kodit civil, si dhe cdo forme tjeter disponimi te njohur nga ligji). Ne rast se operatori ekonomik do ti siguroje mallrat objekt i ketij prokurim nga prodhues te tjere duhet te paraqese autorizim prodhuesi i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “Filara” ShPK, konstatohet, se ky i fundit për pretendimet e ngritura nga ankimuesi ka paraqitur dokumentacionin për disponimin e mjeteve të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur, ku vërtetohet së ka në pronësi dhe me qera pajisjet si në vijim: “- Faturë tatimore shitje me nr. XXXX, datë XXXXXX, lëshuar nga subjekti “XXXXXXXXXX” sh.p.k për subjektin “Filara” sh.p.k, me objekt: “Makine qepse me pe”, “Njësie me origjinalin” nr. 2025 Rep, datë 28.04.2025. - Kontratë Qeraje datë XXXXX me Nr. XXXXX Rep, Nr. XXXXX Kol me qeradhënës subjektin “XXXXXXXX” sh.p.k dhe qeramarrës subjektin “Filara” sh.p.k, në nenin 1 “Objekti i Qerasë” palët kanë rënë dakort si vijon: “Pala qiradhënëse i jep qira palës qiramarrëse makineri printimi, shtypshkrimi, sipas listës të sipërcituar dhe dokumentacionit që i bashkëngjitet kësaj kontrate, me vulë lidhëse noteriale, si më poshtë vijon”. Makineri printimi, Makineri për lidhje libri, Makineri për birimin e letrës, Makineri të tjera kallëpimi, Makineri palosje e perorur, Makineri printimi ofset, Makineri prerje dhe printimi, Makineri ngjitëse e përdorur, Makineri tharëse e përdorur, Makineri shtypi Roland 604 3B me 4 ngjyra, format 72 × 102, Makineri CTP, për përgatitjen e lastrave, e përdorur, Makineri për punime speciale të kopertinave”.

Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit sa i takon mjeteve të kërkuar, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Filara” ShPK nuk e plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të Shtojcës 8/2 të dokumenteve të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Pasi me dokumentacion e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor konkretisht faturës tatimore të shitjes dhe kontratës së qerasë të sipërcituara nuk arrin të provojë se disponon dy makinerit për të cilat ngrenë pretendime ankimuesi në ankesë, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Pra, në rastin konkret KPP gjykon, se operatori ekonomik “Filara” SHPK me

dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe dokumentacionin e dorëzuar pranë AK, nuk arrinë të vërtetojë se e përmbush kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit në lidhje me makineritë, konkretisht për makinerin qepëse me pe dhe makinerin prerëse.

Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me këto kërkesa. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në ofertën e tij “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” ku në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme ka deklaruar, se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, por nga verifikimi i dokumentacionit përkatës të sipërcituar të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nuk rezulton e provuar se ky operator ekonomik disponon makinerin qepëse me pe dhe prerëse sipas kërkesave të autoritetit kontraktor të përcaktuar në kriterin 2.3.5 të dokumentave standarte të tenderit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “*Filara*” SHPK për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Sa më sipër cituar, Komisioni gjykon se operatori ekonomik nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar nuk ka provuar që disponon pajisje/mjetet e deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Inpress*” SHPK për operatorin ekonomik “*Filara*” SHPK qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “*Inpress*” sh.p.k. mbi kualifikimin e shoqërisë “*Filara*” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.9.12., gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “*Filara*” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - mallra mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34415-12-23-2024, me objekt: “Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”, me fond limit 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (dyqind e njëzet e shtate mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 23.12.2024, 1 euro = 98.65 All, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur - mallra mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34415-12-23-2024, me objekt: “Blerje materiale arkive për nevojat e OSHEE Group sh.a”, me fond limit 22,448,930 (njëzet e dy milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH ose 227,561.3 (dyqind e njëzet e shtate mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një pikë tre) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 23.12.2024, 1 euro = 98.65 All, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
 3. Autoriteti kontraktor të skualifikojë operatorin ekonomik “Filara” SHPK, sipas konstatimeve të këtij vendimi.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK.
 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Kristalina KH” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

